25 Shtabit të Përgjithshëm dhe informacion përfshirë këtu dhe

1 urdhrat e marra nga Shtabi i Përgjithshëm.

2 04765 ka qëndruar në Prizren në qershor të 1999 dhe ka  
3 dhënë informacion për njësite të ndryshme të UÇK-së dhe  
4 anëtarë të tjerë atje.

5 Së fundi 04765 ka shkruar shumë dokumente të UÇK-së në  
6 1998 dhe pas luftës ka shkruar një libër lidhur me UÇK-në.  
7 Dokumentin e ka shkruar në 1998 dhe 1999.

8 Ky është përfundimi i përmbledhjes ndërkohë që tani do të  
9 vazhdojmë me pyetjen për dëshmitarin.

10 Si fillim dëshiroj që t'i tregohet dëshmitarit dokumenti  
11 që mban tanimë provën materiale P631, P631-ET përbri me  
12 versionin në shqip. Është dokument i cili mund të transmetohet  
13 edhe për publikun. Faleminderit, znj. Sekretare.

14 PY. A i shikoni dy dokumente përpara në ekran, Dëshmitar?  
15 Njëri është në shqip, dhe tjetri është në anglisht.

16 PË. Po, po.

17 PY. A i njihni këto dokument, dëshmitar?

18 PË. Ju lutem, edhe pak ma nalt ta ngrini ta shoh nënshkrimin  
19 tem, se s'e lexova krejt? Jo ky s'është dokument i im, ky  
20 është dokument i lëshuar nga Bislum Zyrapi.

21 PY. A e keni parë më përpara këtë dokument, dëshmitar?

22 PË. Po.

23 PY. A ju kujtohet se kur e keni parë?

24 PË. Po sigurisht në dhjetor të 1999.

25 PY. Shohim që dokumenti ka të bëjë me një kurs trajnimi të

1 komandantit të batalionit në janar të vitit 1999. A keni

2 njohuri lidhur me këtë kurs trajnimi me komandantë të

3 batalionit, dëshmitar?

4 PË. Po, ky kurs është zhvilluar më vonë nga gjysma e shkurtit

5 deri në gjysmën e marsit, aty kam ligjëru unë në këtë kurs për

6 komandantë të batalioneve.

7 PY. Thoni shkurt-mars, ju lutemi mund ta sqaroni pak më tej?

8 PË. Ai kurs ka zgjatë dikund një muaj.

9 PY. Në çfarë viti, 1998 a në 1999?

10 PË. 1999. Shkurt, mars 1999.

11 PY. A ju kujtohet se ku është zhvilluar ky kurs, ku ka

12 ndodhur ky kurs?

13 PË. Po, në shkollën e Nishorit, komuna e Suharekës.

14 PY. Kush ka marrë pjesë në këtë kurs?

15 PË. Disa prej komandantëve të batalioneve, të përzgjedhur.

16 Ndërsa ligjërues ka qenë Sali Veseli, Bislam Zyrapi, unë edhe

17 të tjerë.

18 PY. Thatë që kanë qenë "disa prej komandantëve të

19 batalioneve". A ju kujtohet se komandantë të kujt batalioneve

20 ose të kujt zonave kanë qenë këta persona në atë kohë?

21 PË. Kryesisht kanë qenë të zonës së Pashtrikut, por ka pasë

22 dhe nga zona të tjera.

23 PY. A ju kujtohet se për çfarë temash bënte fjalë kursi?

24 PË. Sigurisht, për temat e luftës, për çështjet operacionale

25 të luftës, për organizimin e betejave. Di ma mirë për temat që

1 kam zhvillu unë. Unë kam ligjëru në të drejtën e luftës nga  
2 konventa e Gjenevës, të drejtat e luftëtarëve, të drejtat e të  
3 plagosurve, të drejtat civile, të drejtat e të dorëzuarve, dhe  
4 për moralin e luftës, si dhe domosdoshmërinë e luftës për  
5 fitoren, për çlirimin e Kosovës.

6 Z. PACE: [Përkthim] Znj. Sekretare ju kërkoj që t'i hiqni  
7 këto dokumente nga ekрани, dhe tani dëshiroj që t'i tregohet  
8 dokumenti MFI P650650-ET, që është një prej dokumenteve të  
9 tjera të pranuar si provë materiale me këtë dëshmitar. Për  
10 qartësi, po të doni mund të them edhe numrin ERN, është U003-  
11 1741 deri në U003 -- po ky dokument. Përbri versionit në shqip  
12 dhe në anglisht dhe dëshiroj që të kaloni në faqen U003-1744.  
13 Faleminderit, znj. Sekretare.

14 PY. A shikoni dy dokumente të tjerë, Dëshmitar, në të majtën  
15 është në shqip dhe dokument tjetër është në anglisht?

16 PË. Po.

17 PY. Është deklaratë e datës 16 mars 1999 të Halil Qadrakut që  
18 ju është treguar gjatë dëshmisë që i keni dhënë Prokurorisë.  
19 Tani do t'ju tregoj pjesë të caktuara të kësaj deklarate.

20 Z. PACE: [Përkthim] Do i kërkoja Sekretares që të kalojë  
21 tek faqja pasuese, tek 1745. Do lexoj për dëshmitarin nga  
22 fillimi i faqes, pra në anglisht, nga fillimi i faqes ndërkohë  
23 që në shqip është paragrafi 3. Do i kërkoja Sekretares ta ulë  
24 pak faqen në ekran.

25 PY. Mund ta ndiqni ose mund të dëgjoni përkthimin, dëshmitar.

1 Unë do ta lexoj një pjesë dhe do t'ju bëj një pyetje më pas.

2 "Pikërisht më 1 mars 1999, kërkova nga komandant Drini të  
3 më lejonte të shkoja bashkë me eprorin Sadik Halitjaha në atë  
4 brigadë dhe t'i rregullojmë të gjitha problemet e atyre  
5 fshatrave, duke bërë pastaj propozimet për ndërrimet kadrovike  
6 me anë të të cilave do të tejkaloheshin mosmarrëveshjet dhe  
7 pakënaqësitë në ato fshatra, por prapë përgjigja ishte  
8 negative, kështu që unë hoqa dorë sepse pashë që asnjëri nuk  
9 kishte interes që ato të zgjidheshin.

10 "Po ashtu, kam kontaktuar me Shtabin e Përgjithshëm me  
11 Feratin, dhe i kam treguar për të gjitha këto probleme dhe nga  
12 vijnë, dhe si duhet të tejkalohen ato".

13 Dëshmitar, a ju kujtohet apo e dini se kush është Ferati  
14 që përmendet te ky fragmenti që sapo lexova?

15 PË. Dokumentin po e njof. Nuk është fjala se unë kam shku në  
16 Shtab të Përgjithshëm. Aty është fjala e Halil Qadrakut, ka  
17 shku në Shtab të Përgjithshëm, simbas kësaj që ka shkru. Ka  
18 thanë se "Unë shkova në Shtab të Përgjithshëm," sigurisht ka  
19 shku me taku dikënd atje, por ka taku një teknik të shtabit,  
20 Feratin, Feratin. Nuk dihet që ka pasë ndonji rol të  
21 rëndësishëm Ferati në Shtab.

22 PY. A e dini si e ka mbiemrin ky personi Ferat që ka takuar  
23 sipas këtij dokumenti?

24 PË. Po tash e di se është deputet, Ferat Shala.

25 PY. Z. Qadraku të ka thënë ty që ka folë me Ferat Shalën

1 lidhur me çështjen që ceket në këto dy paragrafë?

2 PË. Jo, dokumenti po thotë. Dokumenti po thotë që "unë",  
3 thotë "shkova në Shtab", do të thotë, ai ka shku në Shtab, dhe  
4 paska taku atë.

5 PY. Po, Dëshmitar, dokumenti thotë që ai ka shkuar në Shtab.  
6 Dhe thotë që kam kontaktuar në Shtabin e Përgjithshëm me  
7 Feratin.

8 Nuk jepet mbiemri, kështu që pyetja që të bëra ty është  
9 që nga e dini që Ferati që përmendet në këtë dokument është në  
10 fakt Ferat Shala?

11 PË. Edhe këtu në dokument shkruhet që "takova Ferat Shalën".  
12 Edhe këtu shkruhet, z. Prokuror.

13 Z. EMMERSON: [Përkthim] Ju kërkoj ndjesë që ju ndërpres.  
14 por, në qoftë se kjo është e saktë në shqip, ka një  
15 keqpërkthim sepse thotë që shkova me Feratin, domethënë, këtu  
16 thotë që jam takuar në Shtabin e Përgjithshëm me Feratin, jo  
17 shkova me Feratin.

18 Z. PACE: [Përkthim]

19 PY. Pra, me sa dini ju, Dëshmitar, z. Qadraku këtu e ka fjalë  
20 për Ferat Shalën kur thotë Feratin apo jo?

21 PË. Shqip është drejt e shkrume, u takova me Ferat Shalën.  
22 Shqip është drejt e shkrume. U takova me Ferat Shalën.

23 PY. A keni ndonjë njohuri tjetër të pavarur që Qadraku është  
24 takuar me Ferat Shalën përveç asaj çfarë shkruhet në këtë  
25 dokument? Ke ndonjë burim tjetër informacioni?

1 PË. Jo nuk kam burim tjetër të informacionit. Por e kuptoj  
2 kështu siç është.

3 PY. Në të njëjtën faqe do lexoj një tjetër paragraf. Thuhet  
4 që:

5 "Lidhur me Nasim Mullabazin keni parasysh se ai deri vonë  
6 ka punuar me policinë serbe dhe se është përjashtuar nga SPB-  
7 ja vetëm atëherë kur ata, serbët, e gjuajtën si leckë të  
8 përdorur dhe erdhi tek ne."

9 Kush është Nasim Mullabazi, Dëshmitar? Në qoftë se e dini  
10 kush është?

11 PË. Unë në atë kohë nuk e kam ditë. Përfshirë në letër është  
12 nga Halili, Halil Qadraku, por tani e kam pasë të qartë më  
13 vonë, edhe tash edhe pse është dëshmor, ai ka qenë punëtor i  
14 shërbimit policor të Serbisë, të Jugosllavisë të atëhershme,  
15 dhe në një moment të caktuar kalon në krahun e UÇK-së. Për atë  
16 është fjala, Nasim Mullabazi.

17 PY. A e dini se ku është kyçur, në çfarë batalioni apo çfarë  
18 brigadë të UÇK-së ky person, pra Nasim Mullabazi?

19 PË. Ky është kyçë në brigadën 124 të komanduar nga komandanti  
20 Hoxha.

21 PY. A mund ta thoni si e ka emrin komandanti me mbiemrin  
22 Hoxha nga Brigada 124?

23 PË. Skënder Hoxha.

24 PY. Do lexoj një tjetër pjesë nga e njëjta faqe:

25 "Lidhur me Rexhep Krasniqin, unë dhe Selim Gashi e kemi



1 fajin kryesor sepse ne e ofruam dhe e inkuadruam në këtë  
2 brigadë me sugjerimin e Selim Gashit sepse unë nuk e njihja  
3 atë. Dhe tani ai është zgjedhur si shef i sektorit për moral  
4 dhe informim, por ai atë punë nuk e kryen.”

5 Dëshmitar, pyetja që kam për ju është kjo: Kush është  
6 Selim Gashi?

7 PË. Rexhep Selimi ka qenë zëvendëskomandant i brigadës 124.  
8 Selim Gashi ka qenë S2 në Brigadën 124, dhe këtu thuhet se atë  
9 e paskan propozuar që kanë pranuar kyçjen e tij në brigadë pa  
10 e njoftë se kush ka qenë.

11 Z. PACE: [Përkthim] Znj. Sekretare, mund ta hiqni nga  
12 ekrani këtë dokument.

13 PY. Dëshmitar, në dëshminë për ZPS-në ju thatë që Halil  
14 Qadraku ka qenë G2 në zonë dhe keni bashkëpunuar me të shpesh,  
15 dhe këtu flitet për zonën operative të Pashtrikut, Dëshmitar,  
16 apo jo?

17 PË. Po. Halili ka qenë G2. Siç e kanë qenë edhe departamentet  
18 e tjera, G1, G2, G3, G4, G5, G6. Të gjitha në nivel të zonës  
19 operative të Pashtrikut. Ne të gjithë kemi bashkëpunuar, por  
20 sigurisht se me Halilin kam qenë më i afërt në bashkëpunim,  
21 për shkak se jemi njoftë edhe para lufte.

22 PY. Halil Qadraku, a ka qenë në pozicionin G2 ndërkohë që ju  
23 keni qenë zëvendëskomandant në zonën operative të Pashtrikut?

24 PË. Po, Halil Qadraku ka qenë nga muaji janar i emëruar nga  
25 komandant Drini, Ekrem Rexha, në atë pozicion, G2.

1 Z. PACE: [Përkthim] Znj. Sekretare e seancës, do kërkoja  
2 që të shfaqet në ekran SITF00033776 [sipas përkthimit] deri në  
3 SITF00033379 së bashku me përkthimin SITF00033378 deri në 79-  
4 ET [sipas përkthimit]. Në versionin në shqip dua që të  
5 paraqisni faqen 78-AT, ju lutem.

6 PY. Dëshmitar, a i shihni këto dy dokumente të tjera në  
7 ekran, shqip dhe në anglisht? Përbri njëra-tjetrës?

8 PË. Po, po.

9 PY. A i njihni, e keni parë këtë dokument?

10 PË. E kam pa këtë dokument, ky dokument ka qenë për  
11 transferin e një luftëtari nga zona e Pashtrikut në zonën e  
12 Drenicës. Fjala është për Kimete Krasniqin.

13 PY. Dhe që të jemi të qartë, sepse jua kam treguar këtë  
14 dokument gjatë përgatitjes si dëshmitar, a e kishit parë  
15 përpara atij momenti gjatë përgatitjes, përpara përgatitjes?

16 PË. Jo.

17 PY. Dhe përpara se ta shihnit këtë dokument gjatë seancës  
18 përgatitore, kishte njohuri për Kimete Krasniqin që është e  
19 përmendur në këtë dokument?

20 PË. Po, po.

21 PY. Drejt fundit të këtij dokumenti, shikojmë në pjesën me  
22 shkrim dore --

23 Z. PACE: [Përkthim] Faleminderit Sekretare e Seancës.

24 PY. I referohet këtu Shef Lulit. Kush është Shef Luli? Dini  
25 ju kush mund të jetë Shef Luli?

1 PË. Nuk e di kujt iu ka referu këtu, po e shoh nënshkrimin e  
2 Tahir Sinanit. Nuk e di pse Shef Luli, kush ka mujtë me qenë  
3 atje në Drenicë, nuk e di.

4 PY. Keni dëgjuar ndonjëherë ndokënd që i referohej dikujt  
5 Luli në 1998 a në 1999 tek UÇK-ja?

6 PË. Po, Luli ka qenë pseudonimi i Kadri Veselit.

7 PY. Në fund të këtij dokumenti, në shqip siç e përmendët ju,  
8 me shkrim dore, thuhet të Tahir Sinanit, Tahir Sinani. A e  
9 njihni firmën, poshtë emrit të Sinanit?

10 PË. Shumë mirë e njof se ka qenë komandanti i zonës operative  
11 të Pashtrikut, komandanti jem.

12 PY. Dhe duke u përqendruar tek pjesa e mesit të këtij  
13 dokumenti, pra pjesës përpara shkrimit me dorë, shikojmë një  
14 pjesë që thuhet Halil Qadraku dhe aty është emri i Halil  
15 Qadrakut dhe pastaj firma. E njihni ju atë nënshkrim?

16 PË. Po, nënshkrimi i Halilit është.

17 Z. PACE: [Përkthim] Znj. Sekretare e Seancës, mund të  
18 kalojmë pak lart te ky dokument që ta shikojmë?

19 PY. Dëshmitar, a mund ta shihni këtu që dokumenti ka datën 19  
20 gusht 1999, dhe që Halil Qadraku ka qenë ai që e ka nënshkruar  
21 si shefi i ZKZ-së?

22 PË. Në këtë kohë ka qenë akoma pa u transformuar UÇK-ja në  
23 TMK, do të thotë muaji korrik, normal ka pasë të drejtë Halili  
24 ta nënshkruajë.

25 Z. PACE: [Përkthim] Znj. Sekretare e Seancës, mund t'i

1 heqim këto dy dokumente dhe të shikojmë SITF00379706 deri në  
2 SITF00379706, dhe përkthimi në anglisht me të njëjtën ERN të  
3 saj.

4 PY. Dëshmitar, a i shihni këto dy dokumente të tjera në  
5 ekran? Në shqip në të majtë dhe në anglisht në të djathtë?

6 PË. Po.

7 PY. A e njihni këtë dokument?

8 PË. Po si dokument po e shoh, edhe e njoh nga momenti kur ma  
9 keni prezantu ju. Nënshkrimi është i Halil Qadrakut. Ka të  
10 bëjë me një lirim të një lokali që është uzurpu nga dikush.  
11 Kanë ardhë janë anku në zyrën e tij, dhe ky i jep një urdhër  
12 që të lirohet ai lokali i uzurpuar.

13 PY. Dhe përpara se t'ju tregohej ky dokument nga Prokuroria a  
14 kishit njohuri ju për përmbajtjen e këtij urdhri? Siç e thatë,  
15 pra, që duhet të lirohej objekti afarist?

16 PË. Jo, nuk ka qenë as detyrë e imja të merrem me këto. Nuk  
17 kam qenë i njoftumë.

18 PY. A e njihni nënshkrimin e Halil Qadrakut në këtë dokument?

19 PË. Po.

20 PY. Dhe a mund ta shihni që data është 26 gusht 1999 dhe që  
21 Halil Qadraku e ka nënshkruar si shefi i SHIK-ut?

22 PË. Jo, Halili nuk ka njohur termin SHIK, dhe nuk e ka -- për  
23 të ka qenë njësoj zbulim-kundërzbulim, ZKZ-ja, apo SHIK. Edhe  
24 sot besoj me e pyet i ka të përzime këto terma.

25 Z. PACE: [Përkthim] I nderuar, ne kërkojmë në fakt që të

1 pranohen këto dy dokumente. Pra si përkthimi, edhe dokumenti  
2 tjetër në shqip me përkthimin përkatës.

3 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Që kemi  
4 pikërisht këtë dokument, SITF00033376 deri në SITF00033379,  
5 plus përkthimin në anglisht, pranohen në --

6 Z. KEHOE: [Përkthim] Gjyqtar, nëse mundem që të jap  
7 kundërshtimin tim.

8 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Po, kërkoj  
9 ndjesë.

10 Z. KEHOE: [Përkthim] Në fakt fatkeqësisht i nderuar, ky  
11 është një vendim i marrë tashmë.

12 Së pari, pse po ia tregojmë këtë dokument dëshmitarit?  
13 Besoj që nënshkruesi i këtij dokumenti, pa hyrë në detaje se  
14 kush është ky person, ky është personi që ndoshta duhet të  
15 merret me këtë çështje sepse ky dëshmitar nuk e ka parë  
16 ndonjëherë këtë dokument përpara seancës përgatitore dhe edhe  
17 një herë i tregohet një dokument në seancën përgatitore të  
18 cilin nuk e ka parë më parë. Pra, merret vendimi që t'i  
19 tregohet dëshmitarit një dokument pa ia treguar atë  
20 nënshkruesit të këtij dokumenti që do të duhet ta verifikonte  
21 vërtetësinë e tij dhe nuk mund të vijojmë gjatë viteve të  
22 ardhshme me këto lloj baze që përdor Prokuroria. Pra, për t'i  
23 treguar dikujt një dokument një dëshmitari dhe pastaj për ta  
24 sjellë në Gjykatë. Jemi kundër kësaj praktike.

25 Z. PACE: [Përkthim] Nëse mund të përgjigjem, i nderuar

1 Gjyqtar.

2 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Po, ju lutem.

3 Z. PACE: [Përkthim] Po, faleminderit.

4 Së pari, për dokumentin e parë, dëshmitari ka treguar që  
5 e njihte. Në të dyja dokumentet dëshmitari ka thënë që njihte  
6 nënshkrimin e personit që e ka autorizuar dokumentin. Dhe siç  
7 është e qartë nga pyetjet e mëparshme, personi, pra, që e ka  
8 nënshkruar këtë ka qenë vartës i dëshmitarit, kështu që baza  
9 ekziston, pra, që çfarëdo lloj argumentesh që do të bëhen nga  
10 pala Mbrojtëse e z. Thaçi do të shkojnë, do të kenë peshën e  
11 duhur sa i përket pranueshmërisë.

12 Z. KEHOE: [Përkthim] I nderuar, nëse mundem, edhe një  
13 herë tjetër, kemi të njëjtën mënyre pune nga ZPS-ja, pra  
14 thuhet ky dokument ose cilat dokumente, dëshmitari nuk di  
15 asgjë, dëshmitari i gjorë nuk di asgjë. Nuk ka njohuri për to.  
16 Për shembull i jepet një dokument që shfaqet në ekran dhe në  
17 fakt ai thotë, po thjesht sepse ky person thotë që në fakt  
18 meqenëse e ka nënshkruar Halil Qadraku atëherë duhet të jetë i  
19 vërtetë.

20 Por kjo nuk mjafton, i nderuar Gjyqtar, duhet të kemi  
21 personin që e ka vënë nënshkrimin që të thotë që "po, është  
22 nënshkrimi im dhe është i vërtetë" dhe jo të bëjmë këtë  
23 dëshmitar që të dëshmojë për të, për vlefshmërinë e këtij  
24 dokumenti nga ana e ZPS-së. Thjesht nuk është gjëja e duhur,  
25 është e papërshtatshme kjo si punë nga ZPS-ja.

1 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Atëherë, a ka  
2 bazë të përshtatshme për të treguar që ky dokument në fakt nuk  
3 ka paragjykim, është sepse ashtu siç e kemi dokumentin është  
4 dokumenti SITF00379706 deri në SITF00379706, plus edhe  
5 përkthimin në gjuhën --

6 Vazhdoni, z. Pace. Ndoshta duhet t'i japim edhe një  
7 numër.

8 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Faleminderit, i  
9 nderuar. SITF00033378 deri në SITF00033378-ET dhe në shqip  
10 SITF00033376 deri në SITF00033379 dhe do t'i caktohet numri i  
11 provës materiale P709.

12 E dyta, SITF00379706 deri në SITF0037970 [sipas  
13 përkthimit] bashkë me përkthimin në anglisht do të jetë prova  
14 materiale P710.

15 Dhe unë shënoj të nderuar që këto klasifikohen si  
16 konfidencial, si prova materiale.

17 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] A mund të  
18 riklasifikohen këto dokumente, z. Pace?

19 Z. PACE: [Përkthim] Po, mund të riklasifikohen për  
20 publikun.

21 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Atëherë, të  
22 dyja provat materiale riklasifikohen si publike.

23 Mund të vijoni.

24 Z. PACE: [Përkthim] Faleminderit, i nderuar.

25 PY. Dëshmitar, do t'ju lexoj një fragment nga intervista juaj

1 e mëparshme me ZPS-në dhe më pas do të kem disa pyetje për të.

2 Z. PACE: [Përkthim] Për ju që jeni në sallë, do të lexoj  
3 dhe, e nderuar Sekretare e Seancës, mund të na vini në ekran,  
4 mund të jetë më e lehtë kështu. Bëhet fjalë për 083721-TR-ET,  
5 Pjesa 3 dhe do të filloj nga faqja 22. Ndërsa në gjuhën shqipe  
6 do të jetë nga faqja 25. Në anglisht është nga faqja 22. Pra,  
7 në shqip do të lexoj nga rreshti 2, ndërsa tek anglishtja nga  
8 fundi i faqes, në fund fare, në fakt, të faqes. Faleminderit.  
9 PY. Atëherë, dëshmitar, më lejoni që të lexoj dhe ju mund të  
10 dëgjoni ose përkthimin ose ta lexoni vetë. Dhe më pas do të  
11 kem disa pyetje.

12 "Kanë maltrajtuar një nga Krusha e Vogël. Emrin e kishte  
13 Jakup Muharremi dhe e kanë ndaluar për 24 orë në Reti. Atje ka  
14 qenë me ushtarët, por ushtarë e kanë rrahë, e kanë maltrajtu.  
15 Dhe ia kanë marrë armën se edhe ai ka qenë ushtar dhe e kanë  
16 dërguar në Shtabin e Përgjithshëm. Sigurisht që kanë mendu se  
17 duhet me u penalizu edhe më shumë. Unë nuk e di këtë rast,  
18 edhe pse ka ndodhur në zonën time. Por Jakupin e kanë liruar  
19 kur e kanë kuptuar që ishte ushtar në Budakovë dhe ka  
20 furnizuar batalionin me armë.

21 "Dhe Skënder Hoxha ka qenë një prej atyre personave që e  
22 kanë tejkaluar kompetencat e komandantit për rolin që ka pasë,  
23 dhe për këtë i është dhënë vërejtja, që po merret me punë të  
24 policisë dhe bën punë jo të mira as këtu."

25 Dëshmitar, ne diskutuam rolin e Skënder Hoxhës në UÇK. A



1 mund t'i sqaroni gjyqtarëve për çfarë e keni pasur fjalën kur  
2 keni thënë që Skënder Hoxha ka qenë një prej atyre që i kanë  
3 tejkalu kompetencat?

4 PË. Po nuk ka qenë e drejtë e komandantit të brigadës të  
5 merret me njerëz të dyshimtë siç i ka mbajtur ai në kujtesën e  
6 tij, apo në shënimet e tija. Dhe ndër ta ka futë në atë listë  
7 Jakup Muharremin dhe babën e tij, Imer Muharremin, dhe e ka  
8 marrë në podrumin e komandës të brigadës, e ka maltrajtuar.  
9 Unë jam njofu për këtë rast pas lufte, përndryshe për rastin e  
10 tillë ju është dhënë vërejtje Skënderit, me vonesë kjo  
11 vërejtje ka qenë mbas lufte. Sepse s'ka pasë të drejtë të  
12 ushtrojë një gjë të tillë.

13 Edhe ma keq që unë Jakup Muharremin e kam pasë ushtar në  
14 Budakovë dhe jemi farefis me të. Por nuk kam ditë gjatë luftës  
15 se çfarë ka ndodhë.

16 PY. Dëshmitar, ju folët për një shënim dhe listë që përfshin  
17 Jakupin dhe të atin. A mund të na e sqaroni për çfarë, çfarë i  
18 referoheni sot?

19 PË. Kam pa një listë të ju z. Prokuror, me emra të njerëzve  
20 të shërbimit sekret jugosllav. Nga ato emra kam njoftë Vesel  
21 Krasniqin, Latif Dullën e disa të tjerë që më kanë torturu  
22 edhe mu në burgun jugosllav. Në të njëjtën listë kam pa edhe  
23 emrin e Jakup Muharremit, që s'ka pasë lidhje të bëjë me ata.

24 PY. A e kishit parë këtë listë përpara se t'ju tregohej nga  
25 Prokuroria?

1 PË. Jo, i nderuar.

2 PY. A mund t'u tregoni Gjyqtarëve se kush ju ka informuar për  
3 përfshirjen e Skënder Hoxhës në mbajtjen e Muharremit?

4 PË. Mu më ka informu vetë Jakupi pas lufte krejt çka ka ngja.  
5 Unë nuk e kam ditë rastin gjatë lufte.

6 PY. Dhe më herët, sot, ju përmendët që Skënder Hoxha ka marrë  
7 një vërejtje. A mund ta sqaroni se prej kujt i është dhënë kjo  
8 vërejtje?

9 PË. Prej Tahir Sinanit. Unë nuk kam qenë i njoftumë.

10 PY. Nga e mësuat ju që kishte ndodhur kjo vërejtje e Tahir  
11 Sinanit?

12 PË. Kam mësu pas bisedave që kemi pasë pas luftës, se çka  
13 është bo, dhe kam kuptu që është dhanë vërejtje.

14 PY. Biseda me kë?

15 PË. Bisedat me Jakupin. Jakupi në detale m'i ka spjegu të  
16 gjithë ngjarjen, dhe pastaj për ta qetësu Jakupin dikush ka  
17 bisedu me të, ai ka thanë të mos hakmerresh se atij iu ka  
18 dhanë vërejtje.

19 PY. A dini se kush ka dhënë urdhër për arrestin e Jakup  
20 Muharremit, për mbajtjen e tij, ndalimin?

21 PË. Përgjegjësinë e ka Skënder Hoxha, nuk di kush ka dhanë  
22 urdhën. Ai ka qenë komandant brigade.

23 PY. Dhe a mund ta sqaroni për ne, pra arsyeja që po thoni që  
24 ai kishte përgjegjësi, ka qenë vetëm se ai ka qenë komandant  
25 brigade apo ka edhe ndonjë arsye tjetër?

1 Z. KEHOE: [Përkthim] Kundërshtoj. Jam në -- kundërshtoj  
2 në fakt. Sepse është pyetje sugjestionuese.

3 Z. PACE: [Përkthim] Jo, nuk po bëj asgjë të tillë.

4 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Jo, nuk po  
5 ndodh diçka e tillë.

6 Z. PACE: [Përkthim]

7 PY. Atëherë, në përgjigjen tuaj më herët ju përmendët që  
8 Skënder Hoxha mbante përgjegjësi se ishte komandant brigade. A  
9 mund t'ia sqaroni gjyqtarëve nëse ju mendoni që përgjegjësia e  
10 tij ka qenë vetëm për këtë arsye apo ka patur edhe ndonjë gjë  
11 tjetër që ju çon ta thoni këtë gjë?

12 PË. Po ka përgjegjësi shtesë sepse vetë e ka torturuar. E ka  
13 rrahë.

14 PY. Nga e dini ju këtë?

15 PË. Më ka tregu, pas lufte më ka tregu kushëriri jem Jakupi,  
16 që ka pasun akoma gjurmë të rrahjes.

17 PY. Ju ka thënë Jakupi apo e keni marrë vesh nga ndokush  
18 tjetër për dikë tjetër që ka qenë i përfshirë në keqtrajtimin  
19 apo ndalimin e Jakup Muharremit.

20 PË. Jo, jo, prej Jakupit. Drejtpërsëdrejti prej Jakupit.

21 PY. Dhe në atë fragment që ju lexova nga dëshmia e mëparshme,  
22 keni thënë që i është marrë arma sepse ishte dhe ushtar dhe e  
23 kanë dërguar në Shtabin e Përgjithshëm. Pyetja ime është: Nga  
24 e dini ju që Jakup Muharremin e kanë dërguar në Shtabin e  
25 Përgjithshëm?

1 PË. Ai m'i ka tregu këto, ai ka pasë revole me vete. Edhe ia  
2 kanë marrë revolen në Reti, në komandën e brigadës, dhe kanë  
3 mendu se sipas tyre dikush duhet ta ndëshkojë edhe ma shumë, e  
4 kanë dërgu drejt Shtabi i Përgjithshëm. Por Jakupi më ka thanë  
5 se atje s'ka qëndru ma shumë se 7-8 orë. Ka ndejtë bashkë me  
6 disa ushtarë. Disa kanë kuptu që edhe ky ka qenë ushtar, në  
7 Budakovë, dhe e kanë lirue. Por armën s'e ka pasë. Arma i ka  
8 mbetë te Skënderi.

9 PY. A e mbani mend emrin e babait të Jakup Muharremit?

10 PË. Imer.

11 Z. PACE: [Përkthim] Nëse mund t'i heqim këto dokumente  
12 nga ekрани, dhe t'i tregojmë tashmë dëshmitarit U0001-7854  
13 deri në U0001-8758 [sipas përkthimit], si edhe përkthimin në  
14 anglisht me të njëjtën ERN, dhe ET në fund. Dhe kjo nuk duhet  
15 të transmetohet për publikun.

16 PY. Dëshmitar, shihni sërish që në të majtë keni versionin  
17 shqip dhe në të djathtë anglishten?

18 PË. Po, po.

19 PY. A është ky dokumenti të cilit po i referoheshit pak më  
20 përpara? Që thatë që ishte një dokument që ju ishte treguar  
21 juve nga Prokuroria?

22 PË. Po. Si duket Nasim Mullabazi ia ka dhanë këtë listë  
23 Skënder Hoxhës.

24 PY. Çfarë ju bën ju që ta thoni këtë gjë, pse duket sikur  
25 Nasim Mullabazi ia ka dhënë këtë Skënder Hoxhës?

1 PË. Ai ka qenë në strukturat e policisë jugosllave dhe i ka  
2 njoftë këta bashkëpunëtorë të shërbimit sekret jugosllav, siç  
3 i kam njoftë edhe unë dy-tre prej tyre që më kanë torturuar  
4 gjatë burgut.

5 PY. Tani, më lejoni që të kalojmë tek faqja 7856. Dëshmitar,  
6 jemi në seancë të hapur, ndaj ju lutemi që të mos i referoheni  
7 asnjë emri në këtë listë, thjesht me shifrat përkatëse,  
8 rendore të emrave të tyre, përbri emrave.

9 E kam vënë re që në intervistën tuaj të vitit 2020 me  
10 Prokurorinë, ju keni thënë që nuk e keni njohur personin me  
11 numër 58, që e shihni në ekran, por që ka qenë polic me  
12 policinë serbe.

13 Z. PACE: [Përkthim] Në pjesët 1 dhe 2 të dëshmisë.

14 PË. Është e vërtetë. E vërtetë është. Personi me numër 58 ka  
15 qenë polic i policisë serbe. Dhe pse ka qenë shqiptar me  
16 kombësi.

17 PY. Dëshmitar, pa përmendur sërish emrin, ju lutem shihni  
18 numër 53 dhe tregojuni gjyqtarëve nëse e njihni këtë emër, dhe  
19 nëse po, nga e njihni atë?

20 PË. Ky ka qenë torturuesi im dhe ka punuar në shërbimin  
21 sekret jugosllav në Prizren. Me numër 53.

22 PY. A e njihni emrin tek 54? Sërish, pa e thënë emrin, 54, e  
23 njihni atë emër?

24 PË. Po pse mos ta thojmë emrin, z. Prokuror? Qe këta na kanë  
25 rrehë e na kanë shkoqë me dru. Unë s'ia thom as emrin. Ka

1 vdekë ky majmun. E kam njoftë se ka qenë dhjetë vite sekretar  
2 i sekretariatit sekret të Prizrenit.

3 Z. PACE: [Përkthim] Të nderuar, duhet të kalojmë në  
4 seancë private vetëm për dy pyetjet e tjera që kam dhe besoj  
5 që nuk do të zgjatëm shumë në këto dy pyetje.

6 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Kalojmë në  
7 seancë private për të mbrojtur dëshmitarët, ju lutem.

8 [Seancë private]

9 [Seancë private teksti i fshirë]

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6 [Seancë e hapur]

7 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës,  
8 jemi në seancë të hapur.

9 Z. PACE: [Përkthim] Do kërkoja të kalojmë në faqen e  
10 fundit të dy dokumenteve, në shqip dhe në anglisht, 7858. Do  
11 kërkoja që të zmadhohej versioni në shqip, cepi fare ku ka një  
12 nënshkrim në fund të faqes.

13 PY. Dëshmitar, kur ju është treguar kjo faqe gjatë  
14 intervistës së vitit 2020, ju thatë që mund të shihni një "S"  
15 dhe një "H", por nuk e njihnit nënshkrimin në këtë faqe.

16 Z. PACE: [Përkthim] Dhe kjo është në Pjesën 6, faqja 3.

17 PY. Dëshmitar, pyetja ime është kjo: akoma dhe sot e kësaj  
18 dite nuk e keni të mundur që të njihni se i kujt është ky  
19 nënshkrim në këtë faqe?

20 PË. Nuk jam ekspert i njohjeve të nënshkrimeve por këtu  
21 shihet një H, një S, apo B, e përzier me XH-A. Tash nuk e di  
22 kush mundet me qenë saktë. S'dua të manipuloj.

23 PY. A keni ndonjë dijeni tjetër --

24 Z. PACE: [Përkthim] E tërheq pyetjen, të nderuar  
25 Gjykatës, kërkojmë që të pranohet si provë materiale ky

1 dokument.

2 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Mikrofoni çaktivizuar]

3 Z. KEHOE: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, kemi një listë  
4 emrash, një listë personash, për të cilët ky dëshmitar nuk ka  
5 pikë njohurie dhe nuk është përgatitur fare. Sërish të gjorit  
6 dëshmitar i vendosim një dokument përpara dhe i kërkojmë ca  
7 përgjigje për pyetjet. Nuk ka themelësi ky dokument.

8 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Mikrofoni çaktivizuar]

9 Z. KEHOE: [Përkthim] Po thoja që nuk është e drejtë kjo,  
10 për dëshmitarin, sepse i tregojmë një dokument që nuk e ka  
11 parë asnjë më përpara, përveç seancës përgatitore, dhe t'i  
12 kërkojmë dëshmitarit që të autentifikosh vërtetësinë e këtij  
13 dokumenti nuk është mënyra e duhur për të vazhduar më tej.

14 [Anëtarët e Trupit Gjykses këshillohen]

15 Z. PACE: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, nuk e di në  
16 qoftë se mund t'i përgjigjem shkurtimisht.

17 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Mikrofoni çaktivizuar]

18 [Anëtarët e Trupit Gjykses këshillohen]

19 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Kjo provë  
20 materiale do shënohet për identifikim dhe do vendosim më pas  
21 në qoftë se do ta pranojmë si provë materiale apo jo.

22 Mund të vazhdoni, z. Pace.

23 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës,  
24 dokumenti U001-7854 deri U001-7858 dhe përkthimi në anglisht  
25 do t'i caktohet përkohësisht prova materiale P711 dhe do të



1 identifikohet më pas se ç'do të bëhet me të.

2 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Në rregull.  
3 Mund të vazhdoni.

4 Z. PACE: [Përkthim] Faleminderit, znj. Sekretare, ju  
5 kërkoj që të hiqni këto dokumente nga ekrani dhe më pas  
6 dëshiroj që të shfaqni në ekran përbri njëra-tjetrës dy  
7 dokumente, një në shqip dhe një në anglisht. Dokumenti i parë  
8 është SPOE00209321 deri në 00209428, dhe dokumenti tjetër  
9 është me ET në fund, Revised 1. Këto janë dokumente të cilat  
10 mund të transmetohen për publikun.

11 Faleminderit, znj. Sekretare.

12 PY. Dëshmitar, sa i takon këtij dokumenti në intervistën e  
13 2020 që i keni dhënë ZPS-së --

14 Z. PACE: [Përkthim] Dhe për referencë për ata që janë në  
15 sallën e gjyqit është në Pjesën 6.

16 PY. Ju thoni që:

17 "Jam i sigurt në atë çfarë është shkruar këtu sepse ky  
18 është një libër shkencor. Është teza ime e Masterit dhe është  
19 vlerësuar nga profesorët dhe asgjë që është shkruar këtu nuk  
20 është kundërshtuar."

21 A është e saktë kjo, dëshmitar?

22 PË. Po, ky është libri im, "Ne ishim e ardhmja", libër që i  
23 dedikohet strategjisë së luftës së UÇK-së me fokus të veçantë  
24 të zonës operative të Pashtrikut. Është bazuar në teoritë  
25 shkencore dhe është bërë krahasimi i gueriles së UÇK-së me

1 guerilet e tjera të botës, që është një guerile *sui generis*.  
2 Dhe jam shumë krenar që i jam taku luftës së UÇK-së prandaj  
3 nga libri nuk hjek asgjë, është shumë i vërtetë dhe janë të  
4 gjitha të vërteta.

5 PY. Dëshmitar, do lexoj disa pjesë të librit tuaj dhe do ju  
6 bëj disa pyetje më pas.

7 Z. PACE: [Përkthim] Për Sekretaren, faqet janë njësoj si  
8 në versionin në anglisht dhe në shqip, kështu që dëshiroj që  
9 të fillojmë me faqen që përfundon me 9321 në të dyja  
10 versionet. Është dokumenti 9352, ju kërkohet ndjesë. Atëherë, do  
11 e lexoj nga paragrafi i fundit në të dyja faqet, atëherë  
12 fillon me: "LPRK-në me të drejtë..."

13 PY. Domethënë, do lexoj këtë paragrafin dhe më pas do ju bëj  
14 pyetje, dëshmitar.

15 "LPRK-ja me të drejtë e quan veten si embrioni i lindjes  
16 së UÇK-së, pasi që me një vendim të mbledhjes së tretë të  
17 përgjithshme të muajit tetor 1993 u morën vendime dhe u  
18 caktuan përgjegjësi për krahun e armatosur: Azem Syla,  
19 përgjegjës për organizimin Shqipëri-Kosovë, Xhavit Haliti mori  
20 përgjegjësi lidhur me ndërlidhjen diplomatike mes Shqipërisë  
21 dhe aleatëve perëndimorë, si dhe LPRK-në brenda dhe jashtë  
22 vendit. Ali Mehmeti përgjegjës e koordinues për Maqedoninë,  
23 Fehmi Lladrovci për çështjet ushtarake.

24 "LPRK-ja ka vendosur format dhe pamjen e emblemës si dhe  
25 emrin e UÇK-së".

1 A janë këto informacione të sakta, Dëshmitar?

2 PË. Po, i nderuar Gjykatës, lindja e UÇK-së është nga LPK-ja  
3 dhe njerëzit fillestarë janë ata të caktuar për një  
4 kryengritje të ardhshme.

5 PY. Mund të vazhdojmë të qëndrojmë në të njëjtën faqe, për  
6 procesverbal është ajo që përfundon me 353. Do lexoj një  
7 tjetër paragraf, drejt fundit të kësaj faqeje, që fillon me  
8 "28 nëntor". Fillon "Më datën 28 nëntor", do lexoj dhe pastaj  
9 do ju bëj pyetje, dëshmitar.

10 "Më datën 28 nëntor 1997, në varrimin e mësuesit, të  
11 vrarë nga milicia serbe, UÇK-ja doli hapur. Mujë Krasniqi,  
12 Daut Haradinaj, Rexhep Selimi. Ky i fundit mbajti një fjalë  
13 pranë pjesëmarrësve të shumtë të këtij funerali ku u përkrah  
14 dhe u duartrokit nga mijëra qytetarë prezentë. Nga ky moment  
15 UÇK-ja nderohet e strukturuar, pasi në këtë rast mortor këta  
16 të tre ishin me armë dhe uniformë e folën në emër të UÇK-së.  
17 Nga ky moment populli e njohu ekzekutimin [sipas përkthimit] e  
18 UÇK-së dhe gjithmonë e kanë përkrahur atë. Në këtë fazë,  
19 fillon organizimi në njësitë e vogla e të mesme guerile."

20 A është i vërtetë dhe i saktë ky informacion, Dëshmitar?

21 PË. Ky informacion është shumë publik, veç e kisha hekë  
22 shprehjen që tha Prokurori, nga ka moment doli e strukturuar.  
23 Jo, këto ishin fillet e luftës, dhe këtu ishte fillimi që  
24 lufta dhe UÇK-ja të bëhen publike për popullin tonë dhe për,  
25 edhe për botën, sepse janë bijtë e Kosovës ata që luftojnë për

1 çlirimin e atdheut.

2 T'i heqim dilemat se kush ishin, çka ishin, apo ishin  
3 dorë e shtrirë e huaja. Domethënë, kjo është një dalje  
4 publike. Fjala se, "nga këtu doli e strukturuar", jo, nga këtu  
5 ishin fillet e strukturimit.

6 Z. PACE: [Përkthim] Znj. Sekretare, ju lutem, kalojmë tek  
7 faqja që përfundon me 9371 në të dyja versionet, në shqip dhe  
8 në anglisht.

9 PY. Do lexoj nga fillimi i faqes në të dyja dokumentet.  
10 Përsëri po lexoj, dëshmitar, dhe pasi të lexoj do t'ju bëj  
11 pyetje.

12 "Kurse më 9 maj, në grykë të Llapushnikut, dhe më 12 maj  
13 në një fshat të Rahovecit, kështu që u bënë tri zona zjarri,  
14 Drenicë, Dukagjin, dhe ana e Drinit, zona e Pashtrikut.  
15 Fillimisht njësitë emërtoheshin sipas vendit, sipas  
16 komandantit apo nofkës së tij, dhe emra e simbole të ndryshme  
17 të tilla si Guri, Graniti, Çeliku, Pëllumbi. Ushtarët e këtij  
18 apo atij fshati me emër të fshatit, e me shifra 50, 100, 500,  
19 1000 e të tjerë. Më vonë, me emra të dëshmorëve.

20 "Nga muaji qershor 1998, filloi formimi i strukturave,  
21 skuadrave, togjeve, kompanive, batalioneve dhe më vonë  
22 brigadave.

23 "Përbërjet ishin të ngjashme. Një brigadë përbëhej nga  
24 tre batalione, një batalion tre a më shumë kompani, një  
25 kompani tre a më shumë togje. Një tog tri a më shumë skuadra.

1 Veçmas këtyre, formoheshin njësi elite të quajtura 'speciale',  
2 në nivel të skuadrës, togut, apo kompanisë dhe mbanin emërtime  
3 të ndryshme të ndonjë dëshmori apo ndonjë simboli të tillë si  
4 Syri i Shqiponjës, Tigrat e Zinj, Burgia, Arbëria, Kitrat,  
5 etj. Këto njësi diversante-vëzhguese kanë luajtur rol të  
6 veçantë dhe më së shumti e dëmtuan armikun në luftë.

7 Pyetja që kam për ju është kjo, Dëshmitar: A është i  
8 saktë ky informacion?

9 PË. Po.

10 Z. PACE: [Përkthim] Znj. Sekretare, mund të vazhdojmë në  
11 faqen 9399 [sipas përkthimit]. Do të lexoj nga mesi i faqes,  
12 ku fillon me: "Kjo është e veçanta tjetër..."

13 PY. Do lexoj përsëri:

14 "Kjo është e veçanta tjetër se asnjë dezertim nga radhët  
15 e UÇK-së nuk kaloi në anën e armikut, askush nuk shkoi në anën  
16 e armikut.

17 "Kurrë armiku s'mundi të krijonte qoftë dhe një njësi të  
18 vetme shqiptare kundër UÇK-së në luftë."

19 Dëshmitar, a është i saktë ky informacion?

20 PË. Informacioni është i saktë dhe është kënaqësi e madhe që  
21 nuk ka ndodhë një diçka e tillë, përndryshe do të bëhej  
22 vëllavrasje mes shqiptarëve nga shtytja e serbëve me atë ekip  
23 që kishim me kriju mbrenda vetes. Asnjherë nuk pranuan  
24 shqiptarët që të radhiten në njësitë e forcave armike serbe.

25 Z. PACE: [Përkthim] Znj. Sekretare e seancës, të kalojmë

1 te faqja që përfundon me 9401 në të dyja versionet. Atëherë do  
2 të fillojmë me fundin e kësaj faqeje dhe do të vazhdojmë me  
3 faqen pasuese. Do fillojmë te "Riorganizimi..." dhe më poshtë.  
4 PY. Dhe një herë, dëshmitar, do të lexoj një pjesë dhe pastaj  
5 do ju bëj një pyetje:

6 "Riorganizimi në nivel nënzone filloi më 26 nëntor 1998,  
7 dhe më pas në zona nga fundi i dhjetorit 1998, në fillim të  
8 janarit 1999. Parimisht 3 batalione bënë një brigadë dhe tre  
9 brigada bënë një zonë. Kishte gjithashtu edhe përjashtime në  
10 bazë të stadiit organizativ e të konfiguracionit të terrenit.  
11 Ndarja filloi me qëllim të marrjes së përgjegjësive dhe të  
12 kontrollit në terren. Në këtë kohë, emërtimet vinin nga Shtabi  
13 i Përgjithshëm për komandantët dhe zëvendëskomandantët e  
14 zonave. Ndërsa për komandantët e brigadave dërgohej për  
15 propozim vendim nga zona dhe aprovohej nga SHP-ja, Shtabi i  
16 Përgjithshëm. Për komandantët e njësive më të ulëta, vendoste  
17 komanda e zonës. Në të gjithë Kosovën operuan shtatë zona.  
18 Ndarja e territoreve që mbulonin me luftime u bë sipas  
19 terrenit dhe konfiguracionit të mundshëm për menaxhim të  
20 veprimit luftarak. Kështu që njëra me tjetrën kishin të  
21 përcaktuara terrenin si dhe njësitet përbërëse të tyre. Me  
22 qëllim të komandimit e drejtimit si dhe përgjegjësive e  
23 llogaridhënies për zonën e njësisë së saj, UÇK-ja pati  
24 policinë ushtarake, PU, nga niveli i Shtabit të Përgjithshëm  
25 deri në nivel brigade. Vetëm batalioni në Budakovë pati njësi

1 për shkak të specifikave të krijimit dhe të terrenit që  
2 kishte.”

3 Prapë, a është i saktë ky informacion, Dëshmitar?

4 PË. Po, veç desha pak të plotësoj, se këto zona nuk kanë  
5 mundë ta mbulojnë dhe ta kontrollojnë tërësinë e territorit të  
6 vet që e kanë pretenduar që kanë manovruar me luftime, sepse  
7 territori ka qenë i kontrolluar nga forcat armike, ma shumë se  
8 80 për qind dhe ka qenë pjesë-pjesë i ndamë sikur që është  
9 lëkura e leopardit. Kështu që është e pamundshme dhe ka qenë e  
10 pamundshme të kontrollohej hapësira tërësisht ashtu si është  
11 ndarë zonat.

12 Për njësinë policore të batalionit të Budakovës ka qenë  
13 specifikë e veçantë sepse batalioni i Budakovës ka qenë i  
14 ndarë komplet nga njësitë e tjera në distancë gjeografike dhe  
15 derisa s'kanë mujtë me ndodhë edhe lidhjet mes njësive të  
16 Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës duke qenë se forcat serbe në  
17 mes, duke i kontrolluar ata rrugët kryesore, qytetet, dhe  
18 hapësirën kryesore të Kosovës, u desh të bëhej një përjashtim  
19 i vogël që të bëhej një skuadër policore në batalionin e  
20 Budakovës. Veç plotësim desha të bëj.

21 Z. PACE: [Përkthim] E nderuar Sekretare e seancës, do ju  
22 kërkoja që të kalojmë tek faqja 9407 në të dyja versionet dhe  
23 do ju lexoj një tjetër pjesë dhe pastaj do ju bëj një pyetje,  
24 dëshmitar. Po lexoj nga pjesa "operacionet teknike --

25 PY. "Direktivat teknike, operative, strategjike të Shtabit të

1 Përgjithshëm luanin një rol të rëndësishëm në efektivitetin e  
2 luftimeve të UÇK-së.

3 A e është e saktë kjo Dëshmitar?

4 PY. Taktike, jo teknike. Vetëm këtu është. Edhe arsyeja është  
5 se taktika e njerëzve që kanë qenë në Shtabin e Përgjithshëm  
6 ka qenë shumë e mirë për shkak se ata s'kanë qëndruar  
7 asnjëherë në të njëjtin vend, dhe i kanë ndërru vendet nëpër  
8 tërë Kosovën, edhe jashtë Kosovës. Kështu që Serbia apo ma  
9 drejt me thanun, forcat armike serbe, s'kanë mujtë me arritë  
10 t'i zënë apo t'i vrasin. "Taktike" jo "teknike".

11 Z. PACE: [Përkthim] Do kaloj tek një pjesë e fundit, një  
12 paragraf i fundit për këtë libër. Që është faqja 9415, do  
13 lexojmë paragrafin e dytë nga kjo faqe. Një moment, ju lutem.  
14 "Në UÇK zinxhiri komandues..."

15 PY. Përsëri, kjo është hera e fundit që do lexoj një paragraf  
16 nga ky libër, pastaj do ju bëj një pyetje lidhur me këtë,  
17 dëshmitar. Në paragrafin e dytë thuhet:

18 "Në UÇK është respektuar zinxhiri komandues që nga Shtabi  
19 i Përgjithshëm, komandantët e zonave, komandant brigade,  
20 komandant batalioni, komandant kompanie, komandant togu, dhe  
21 komandant skuadre.

22 "Ky zinxhir komandimi ishte shumë i zbatuar dhe i  
23 përcaktuar me rregullore të brendshme, dhe rregullore  
24 rreshtore e disiplinore. Edhe pse nuk kishim grada,  
25 komandantët ishin të njohur për të gjithë nga autoriteti dhe



1 fama e tyre, por edhe nga trimëritë që kishin të shndërruar,  
2 që ishin të shndërruar gati në legjenda. Në asnjë mënyrë  
3 komandantët nuk ishin të privilegjuar, përkundrazi kishin më  
4 tepër përgjegjësi dhe ishin gjithmonë më të rrezikuarit.”

5 A është i saktë ky informacion, Dëshmitar?

6 PË. Është i saktë. Desha të shtoj se nga Shtabi i  
7 Përgjithshëm nuk kemi pasë urdhra me shkrim dhe nga Shtabi i  
8 Përgjithshëm nuk kemi pasë protokolle mes zonës dhe Shtabit të  
9 Përgjithshëm. Këto rregulla, krejt këtu çka shkrujnë, janë  
10 shumë të vërteta, që nga niveli i zonës deri në nivelin e  
11 skuadrës është punuar në rregullore sepse rregulloret i kanë  
12 nxjerrë zona. Rregulloret i kemi ba ne. Unë edhe Halil  
13 Qadraku, me S1, Vesel Maliqin.

14 Dhe kështu ka funksionuar vërtet zinxhiri komandues. Po  
15 të kishte urdhra, çfarëdo qofshin ato nga Shtabi i  
16 Përgjithshëm që ne ma shumë kemi pritë nga Adem Demaçi sepse  
17 për mu ka qenë idol Adem Demaçi, e kam ditë se ai është t'u  
18 drejtu luftën. Ai ka thanun që mos takohemi me gazetarë pa  
19 lejen e tij, s'jemi taku, s'kemi dhanë intervista pa lejen e  
20 tij. Çdo gjë kam pritë dhe kena pritë të gjithë nga ai.  
21 Përndryshe, nuk ka pasë urdhër protokollues nga asnjëna palë,  
22 a zinxhiri komandues në nivel të zonës dhe deri në skuadër ka  
23 shku shumë mirë.

24 PY. Dëshmitar, kur keni marrë urdhra nga Shtabi i  
25 Përgjithshëm që nuk ka në qenë me shkrim a janë zbatuar ato

1 urdhra në nivel zone?

2 PË. Po, sigurisht. Kemi pasë dy urdhra që mbaj mend. Njëni  
3 urdhën ka qenë mobilizimi i përgjithshëm i UÇK-së dhe i  
4 popullit për luftë. Urdhri i dytë ka qenë përkujdesja e shtuar  
5 dhe e domosdoshme për civilët gjatë kohës së granatimit të  
6 NATO-së që të mos hakmerrej, mos të hakmerreshin forcat serbe  
7 ndaj civilëve.

8 Këto dy urdhra sa kujtoj unë, njëni është dhënë përmes  
9 Radios Kosova e Lirë, tjetri është dhënë me gojë. Janë zbatu  
10 përpikërisht.

11 PY. Dëshmitar, do kalojmë tek një pjesë që sapo lexova. Ju  
12 thoni që:

13 "Komandantët nuk ishin të privilegjuar në asnjë mënyrë,  
14 përkundrazi kishin më shumë përgjegjësi dhe ishin ata që ishin  
15 më të rrezikuarit."

16 Dëshmitar, në role të ndryshme që keni pasë si komandant  
17 dhe zëvendëskomandant në 1998 dhe 1999, a e keni ndier ju që  
18 keni pasur më shumë përgjegjësi sesa vartësit tuaj?

19 PË. Unë e kam përjetu këtë pasi që kam qenë zëvendëskomandant  
20 i zonës operative të Pashtrikut. Komandantët e vërtetë janë  
21 kanë më të rrezikuarit sepse në rregullat e Ushtrisë  
22 Çlirimtare të Kosovës ka qenë "ejani pas meje"; jo "shkoni ju  
23 atje bëni luftën". Dhe kështu në këtë drejtim unë kam qenë  
24 gjithmonë në vijën e zjarrit, në vijën e parë të zjarrit, dhe  
25 kam marrë pjesë në ma shumë se dhjetë beteja. Njëkohësisht jem

1 plagosur dhe kam shtatë plagë. Po ashtu, kam pasë një rast që  
2 kam ra në pritë dhe aty kam marrë një plagë, dhe për fat e  
3 kemi çelur pritën, duke i asgjësuar ata të pritës.

4 Kështu që, komandantët kudo që kanë qenë dhe ngado që  
5 janë sjellë në nivel të luftës kanë pasë rreziqe ma të mëdha.  
6 Nuk ka qenë privilegj të jesh komandant, por ka qenë  
7 përgjegjësi dhe ka qenë rrezik i madh.

8 Kisha dashtë me shtu, nëse më lejohet, për punën e  
9 pritave.

10 Ne kemi shumë raste të njerëzve që na kanë ra në prita,  
11 kemi edhe njerëz të zhdukur në prita, të asgjësuar, kemi  
12 njerëz të cilët janë vra në prita dhe i kanë shpëtu shokët e  
13 tyre dhe janë thanë shumë thashetheme se pse këtu përmendet  
14 shumë emra të, lufta speciale e armikut kundër luftës së UÇK-  
15 së. Shumë thashetheme janë mbërritë për ata që janë vra në  
16 pritë e që s'kanë pasë kush ta tregojë se si është vra, ku  
17 është mbetë, kemi rastin për shembull për [E pakuptueshme]  
18 Ademaj, kemi rastin e veçantë për Sakip Bellaqën, me dy shokë  
19 të tjerë që mbetën në pritë. Kemi rast të veçantë për Shaban  
20 Shalën, e të tjerët --

21 PY. Në rregull, Dëshmitar. Se po shkojmë pak përtej asaj  
22 çfarë ju pyeta.

23 PË. Kërkoj falje.

24 PY. Thjesht dua ta sqaroj. Kur ju pyeta lidhur me fjalinë,  
25 fjalia ka dy pjesë. Pjesa e parë është që komandantët kishin

1 më shumë përgjegjësi, dhe ata ishin më të rrezikimit. Kjo  
2 ishte pjesa e dytë. Unë ju pyeta lidhur me përgjegjësinë më të  
3 madhe që kishin komandantët. A mund t'i tregoni Trupit Gjykues  
4 në role të ndryshme si komandant, si zëvendëskomandant i UÇK-  
5 së që e keni ndier që kishit më shumë përgjegjësi se sa  
6 vartësit tuaj?

7 PË. Gjithsesi, sepse përgjegjësia është jo vetëm për të  
8 luftuar, për ta organizu luftën, për të organizuar betejat,  
9 për të drejtuar ushtarët, për t'i strehuar ushtarët, për t'i  
10 armatosë ata, për t'u kujdesë për popullatën civile. Unë në  
11 zonën time kam pasë rreth 200 000 civilë që janë kanë të  
12 mbrojtur nga UÇK-ja dhe jemi kujdesë për ta edhe për ushqime,  
13 edhe për ilaçe, edhe për strehim edhe për të gjitha.

14 Përgjegjësia e komandantëve ka qenë shumë e madhe, por  
15 edhe sjelljen e ushtarëve, për sjelljen e tyre mes vete, të  
16 gjitha këto komandanti ka përgjegjësi.

17 Z. PACE: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, përpara sesa të  
18 bëjmë pushimin, kërkoj që faqet që iu treguan dëshmitarit të  
19 pranohen si prova materiale.

20 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Mikrofoni çaktivizuar]

21 Z. KEHOE: [Përkthim] Sa i takon faqeve që i treguan  
22 dëshmitarit nuk kemi kundërshtim.

23 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Filluat me  
24 faqen që përfundon me 9352? Kjo ishte faqja e parë?

25 Z. PACE: [Përkthim] Po, e saktë, i nderuar Gjykatës.

1 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Sa i takon  
2 dokumentit SPOE009351 [sipas përkthimit] dhe SPOE009428 [sipas  
3 përkthimit], fragmentet e faqeve që iu lexuan dëshmitarit  
4 pranohen si prova materiale. Faqet që iu lexuan dëshmitarit  
5 përfundojnë me 9352, 9371, 9399, 9401, 9407 dhe 9415.

6 Z. PACE: [Përkthim] Për të sqaruar, ka dhe dy faqe të  
7 tjera të cilat kalova te faqja pasuese, domethënë, filluan me  
8 një faqe, por përfunduan te faqja tjetër. Në qoftë se më  
9 lejoni dua që t'i jap për procesverbal dhe këto faqe.

10 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Po, mund t'i  
11 jepni.

12 Z. PACE: [Përkthim] Atëherë, unë lexova 9401 deri në  
13 9402, kështu që duhet të pranohet dhe 9402. Dhe besoj se kaq  
14 ishte, vetëm një çast që të sigurohem që nuk lashë ndonjë gjë  
15 pa përmendur, të nderuar Gjykatës.

16 Faleminderit për kohën, kaq kisha. Besoj që ka ardhur  
17 momenti për të bërë pushimin.

18 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Vetëm një  
19 dokument tjetër ishte plus, atëherë?

20 Z. PACE: [Përkthim] Po, vetëm një faqe tjetër.

21 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Edhe  
22 dokumenti 9402 pranohet si provë materiale.

23 Z. EMMERSON: [Përkthim] Nuk dua të flas, të mbivendosem  
24 me Sekretaren, por dua që të kërkonim dy-tre minuta më tepër  
25 në mënyrë që të tillë që të dimë se çfarë do të bëjmë sot

1 pasdite, çfarë do bëjmë nesër.

2 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës,  
3 këto faqe do të marrin numrin e provës materiale P712.

4 Po ashtu, për procesverbal, mendoj që të gjitha këto  
5 dokumente duhet të shënohen me konfidenciale, apo jo. Apo mund  
6 të ndryshohet klasifikimi i tyre?

7 Z. PACE: [Përkthim] Të gjitha faqet e pranuar në këtë  
8 libër mund të riklasifikohen si publike.

9 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Dëshmitar,  
10 tani do të bëjmë pushimin e drekës. Do silleni përsëri në  
11 sallën e gjyqit në orën 14.30. Ju lutem, dilni nga salla së  
12 bashku me Sekretaren.

13 [Dëshmitari përfundon dëshminë]

14 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Jemi në  
15 seancë publike, apo jo?

16 Sa për kujtesë për palët, besoj që e kam thënë keq, në  
17 fakt, të enjten, por nesër dhe pasnesër do fillojmë në orën  
18 15.00 dhe do vazhdojmë deri në orën 19.30.

19 Z. EMMERSON: [Përkthim] Sa i takon dëshmitarit dhe sa i  
20 takon kalendarit, dhe në qoftë se dëshmitari tjetër do përdorë  
21 të dyja ditët e planifikuara, i takon që të kemi goxha pushim,  
22 goxha pauzë në dëshminë e këtij dëshmitari.

23 Domethënë ndoshta mund edhe të kthehemi edhe të mërkurën,  
24 për shembull, në qoftë se përfundojmë me dëshmitarin e radhës  
25 të martën, besoj që mund të vazhdojmë edhe të mërkurën me këtë

1 dëshmitar.

2 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Po, por do  
3 jetë vonë në darkë.

4 Z. EMMERSON: [Përkthim] E kuptoj këtë gjë.

5 Por thjesht dua të kuptoj se në çfarë pike është z. Pace  
6 në pyetjet e tij për dëshmitarin, sa për të kuptuar se sa kohë  
7 do i duhet sot pasdite për të vazhduar me pyetjet e tij, sepse  
8 pa diskutim, domethënë, që unë do filloj me kundërpjetet e  
9 mia se nuk dua që të harxhoj kohë.

10 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Po, besoj që  
11 është pyetje e mirë.

12 Z. PACE: [Përkthim] Kemi vlerësuar që na duhen dy orë.  
13 Kam përdorur një orë e gjysmë, nuk parashikoj që të më duhet  
14 më shumë se gjysmë ore. Nuk ka arsye që të më duhet më shumë  
15 sesa kaq.

16 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Atëherë do  
17 keni një orë sot pasdite, i takon, z. Emmerson.

18 Po edhe sa kohë pastaj ju duhet?

19 Z. EMMERSON: [Përkthim] E kemi diskutuar qëndrimin tonë  
20 ndërmjet ekipeve të Mbrojtjes, domethënë, 14 orë janë pak më  
21 shumë sesa ç'na duhet të gjitha ekipeve të Mbrojtjes. Dhe duke  
22 marrë parasysh urdhrin tuaj të kohëve të fundit që duhet të  
23 shkurtojmë orën, ne e kemi shkurtuar kohën tonë nga katër në  
24 dy orë e gjysmë. Pra kohën e marrjes në pyetje të dëshmitarit.  
25 Por duke qenë që ramë dakord ndërmjet ekipeve të Mbrojtjes që

1 unë do jem personi që do i bëj i pari pyetje dëshmitarit, dua  
2 që të kërkoj edhe një orë shtesë plus këtij dy pikë pesë  
3 orëshit që kam planifikuar fillimisht për këtë dëshmitar.

4 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Po pjesa  
5 tjetër? Po ekipet e tjera të Mbrojtjes, në qoftë se z.  
6 Emmerson përdor tre orë e gjysmë?

7 Z. KEHOE: [Përkthim] Nuk jam shumë i sigurt, se kemi disa  
8 çështje të rëndësishme që na duhet të kalojmë me këtë  
9 dëshmitar që kanë lidhje me klientin tonë. Kam përshtypjen që  
10 kam planifikuar gjashtë orë. Unë nuk mendoja se mund të mbaroj  
11 përpara katër orësh, megjithatë do të shoh se si do shkojë  
12 procesi. Por të paktën do më duhen katër orë.

13 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Atëherë është  
14 e qartë që ky dëshmitar do vazhdojë dhe pas pushimit të gjatë.  
15 Nuk e shmangim dot, domethënë, do na ndodhte në një moment.  
16 Herët e vonë do ndodhte kjo gjë.

17 Z. Roberts, sa kohë ju duhet? Nuk dua që t'ju vë para  
18 pozitës, por thjesht, domethënë, dua të di sesa mendoni, sa  
19 kohë ju duhet për të marrë në pyetje dëshmitarin?

20 Z. ROBERTS: [Përkthim] Tre orë, dhe me çfarë pres nuk më  
21 duhen më pak ose më shumë. Besoj se kaq më duhen. Kemi dhe  
22 avantazhin e pauzës ose pushimit, ndoshta mund ta reduktoj dhe  
23 zvogëloj dhe më shumë këtë kohë. Megjithatë në qoftë se do më  
24 duhet më pak kohë, do ju informoj si juve të nderuar anëtarë  
25 të Trupit Gjykues dhe Prokurorisë.



1 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Znj.

2 Alagenda?

3 ZNJ. ALAGENDRA: [Përkthim] Ne kemi parashikuar tre orë,  
4 dhe planifikojmë që të përdorim tre orë.

5 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Në rregull.  
6 Mirë atëherë të paktën e dimë që do na duhet që të merremi  
7 përsëri me këtë dëshmitar ndoshta dhe pas pushimit. I vlerësoj  
8 të gjithë për vlerësimet e sinqerta. Tani do bëjmë pushimin  
9 deri në orën 14.30.

10 --- Pauza e drekës fillon në orën 13.05

11 --- Seanca rifillon në orën 14.30

12 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] E nderuar  
13 Sekretare e seancës, ju lutem, të sillni dëshmitarin.

14 Z. PACE: [Përkthim] Në fakt nëse mund t'i përgjigjem unë  
15 pyetjes që ka të bëjë me pranimin e materialeve, provave.

16 Atëherë në këto rrethana, meqenëse nuk ka kundërshtim për  
17 pranimin e provës 115866 dhe në lidhje me rastin tjetër që  
18 është SPOE00111714 ne nuk jemi kundër pranimin të saj, por nuk  
19 ka arsye, sepse do të duhet që të pranohet vetëm me një synim  
20 të kufizuar, me qëllim të kufizuar.

21 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Atëherë në  
22 rregull. 115866 dhe 111714 pranohen të dyja dhe do t'u  
23 caktohet një numër.

24 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Atëherë, të nderuar,  
25 SPOE00111714 do të pranohet si provë materiale ED4D9 dhe

1 115866 si prova 4D10.

2 [Dëshmitari vijon dëshminë]

3 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Në rregull.

4 Dëshmitar, jemi të gatshëm që të vijojmë tashmë edhe gati për  
5 të vijuar me pyetjet e drejtpërdrejta. Z. Pace ka ende disa  
6 pyetje për ju.

7 Z. PACE: [Përkthim] Faleminderit, i nderuar.

8 PY. Dhe mirëdita, Dëshmitar.

9 PË. Mirëdita.

10 PY. A e njihni dikë me emrin Bashkim Ndrecaj?

11 PË. Po.

12 PY. Ka qenë anëtar i UÇK-së?

13 PË. Po.

14 PY. Kur?

15 PË. Ka qenë që nga fillimi i luftës në Budakovë në njësinë e  
16 quajtur speciale.

17 PY. Dhe ku ka qenë kjo njësi speciale e vendosur edhe kjo në  
18 Budakovë apo gjëkund tjetër?

19 PË. Kjo ka pasë selinë në Budakovë, por ka qenë e lëvizshme,  
20 mobile.

21 PY. Dhe kush e drejtonte këtë njësi speciale të cilës i  
22 referoheni?

23 PË. Arben Basha, Abi.

24 PY. Në përkthim u tha Alpen Basha, Alpen?

25 PË. Arben, Arben; Alpen nuk ekziston.

1 PY. A jeni takuar me Bashkim Ndrecajn gjatë luftës,  
2 domethënë, në '98-'99?

3 PË. Sigurisht, dy-tri herë ma shumë në praninë e të tjerëve.  
4 Siç edhe jam taku edhe me ushtarë të tjerë.

5 PY. Në Budakovë apo gjëkundi tjetër?

6 PË. Sigurisht në Budakovë, në rrethinë të Budakovës. Nuk kam  
7 specificitet të veçantë ku e kam taku, se s'ka pas rëndësi. Ka  
8 qenë një ushtar i thjeshtë.

9 PY. Atëherë kalojmë te një çështje tjetër.

10 Z. PACE: [Përkthim] Sekretare e seancës dëshiroj që t'i  
11 tregoj dëshmitarit, t'i shfaqim një video. Është 067205-01 dhe  
12 dëshiroj që të fillojmë nga minuta e 8 dhe 15 sekonda. Dhe  
13 mund të shfaqet edhe për publikun, por nuk ka arsye se pse të  
14 jetë me zë dhe do ta njoftoj unë Sekretaren e seancës se kur  
15 mund ta ndërpresim transmetimin e videos, në ç'moment.

16 [Luhet videoincizimi]

17 Z. PACE: [Përkthim]

18 PY. Dëshmitar, Sekretarja e Seancës do të shfaqë një video;  
19 do të doja që ta shikonit atë dhe në një moment do t'i kërkoj  
20 Sekretares së seancës ta ndalojë atë dhe do të kem disa pyetje  
21 për ju.

22 Z. PACE: [Përkthim] Dhe Sekretare, ju them juve që kërkoj  
23 që ta ndaloni videon në 8:44 minuta. Mund të shfaqni videon.

24 [Luhet videoincizimi]

25 Z. PACE: [Përkthim] Mund ta ndalojmë këtu videon.

1 Faleminderit, Sekretare e seancës.

2 PY. Dëshmitar, a e njihni këtë vend i cili ka dalë në ekran  
3 në këtë moment në minutën 8 dhe në sekondën e 44?

4 PË. Po, këtu jam në Prizren. Si duket është dita e dytë e  
5 çlirimit të Prizrenit. Jemi para kuvendit komunal, para  
6 komunës, ish-komunës së Prizrenit, komuna e vjetër. Unë kam hy  
7 më 11 qershor në Prizren. Kjo duhet të jetë me 13 qershor të  
8 '99.

9 Z. PACE: [Përkthim] Sekretare e seancës dëshiroj që të  
10 vijojmë me regjistrimin e kësaj video dhe të ndalosh sërish,  
11 të ndaloni sërish në 09:03.

12 [Luhet videoincizimi]

13 Z. PACE: [Përkthim] Mund ta ndalojmë këtë, faleminderit.

14 PY. Dëshmitar, a njeh ndokënd në këtë mesazh, në këtë ekran  
15 pasazh që ka ndaluar?

16 PË. Shumë pak njoh këtu. Njoh me këto teshat e zeza, Isuf  
17 Krasniqin. Nuk i njoh ushtarët të gjithë se kanë ndryshu  
18 shumë. Unë jam këtu shihet që jam. Nuk i njoh të tjerët.

19 Z. PACE: [Përkthim] Znj. Sekretare e seancës, a mund të  
20 ndihmoni dëshmitarin që të vendosë numra ose shifra tek  
21 personat përkatës?

22 PY. Pra, me ndihmën e Sekretareve, a mund të vendosni numrin  
23 1 tek personi që keni identifikuar si Isuf Krasniqi?

24 PË. Po. [Shënon]

25 PY. Faleminderit edhe numrin 2 tek personi që keni

1 identifikuar si vetvetja.

2 PË. [Shënon]

3 Z. PACE: [Përkthim] Znj. Sekretare, a mund ta printojmë  
4 këtë pasazh që kemi në ekran dhe ta bëjmë atë pjesë të  
5 seancës? Do të vijoj duke treguar disa gjëra të tjera dhe  
6 natyrisht do t'ju bëj disa pyetje më pas.

7 Nëse mund të vijojmë me videon dhe pastaj ta ndalojmë atë  
8 tek minuti i 10-të dhe sekondi i 30-të, ju lutem.

9 [Luhet videoincizimi]

10 Z. PACE: [Përkthim] Mund ta ndalojmë këtu videon.

11 PY. Dëshmitar, a njihni ndokënd tani në ekran?

12 PË. Po. Këtu shoh ushtarët tuj u përçafu, tuj gëzuar pas  
13 çlirimit. Si duket kjo ka qenë një ditë më vonë, domethënë,  
14 dikun me 14 apo ndoshta dhe 15 qershor. Në pritje kemi qenë të  
15 Tahir Sinanit edhe të Fatmir Limës të cilët kanë ardhun për  
16 herë të parë në Prizren atë ditë pas çlirimit.

17 PY. Dëshmitar, a njeh ndokënd tjetër ose a mund të na jepni  
18 emrat e ndonjë personi tjetër që kanë mbetur tani në ekran nga  
19 videoja në minutën e 10-të se sekondën e 30-të që është  
20 ndaluar?

21 PË. Këtu njoh vetëm Tahir Sinanin edhe Fatmir Limën.

22 Z. PACE: [Përkthim] A mund t'i kërkoj Sekretares së  
23 Gjykatës që të ndihmojë dëshmitarin që të vendosë numrin 1 tek  
24 personi që keni identifikuar si Tahir Sinani, ju lutem?

25 PË. [Shënon]

1 PY. Dhe e pashë që ju keni vendosur numrin 2, a mund të  
2 vendosni me shigjetë Fatmir Limajn ngjitur me numrin 2 që të  
3 jetë e qartë.

4 PË. [e pakuptueshme] duket shumë është --.

5 Z. PACE: [Përkthim] Faleminderit. Edhe një herë, znj.  
6 Sekretare e seancës, pra, nëse mund ta kemi këtë për t'u  
7 pranuar. Dhe të vazhdojmë më pas në Gjykatë dhe më pas të  
8 vazhdojmë deri me shfaqjen e videos.

9 [Luhet videoincizimi]

10 Z. PACE: [Përkthim] Po, mund ta ndalojë këtë videon, ju  
11 lutem.

12 PY. Dëshmitar, a njihni ndonjë nga këta persona në ekran  
13 tani?

14 PË. Po, unë isha tuj u përshëndet me Fatmir Limën.

15 Z. PACE: [Përkthim] Znj. Sekretare, nëse mund ta ndihmoni  
16 dëshmitarin në mënyrë që të vendosni numrin 1 tek juve dhe  
17 numrin 2 tek Fatmir Limaj, ju lutem.

18 PË. [Shënon] Po.

19 PY. Faleminderit, Dëshmitar.

20 Z. PACE: [Përkthim] Dhe Sekretare e Seancës, ju kërkohet  
21 juve që të bëni një fotografi të kësaj pjese dhe tani të  
22 vijojmë me pjesën e fundit të videos edhe 8 sekonda të tjera  
23 deri në 11:28.

24 [Luhet videoincizimi]

25 Z. PACE: [Përkthim] Faleminderit. Mund ta mbarojmë me

1 videon tani.

2 Dhe të nderuar kërkoj që të pranojmë të gjitha ato  
3 fotografime që bëmë të aspekteve të ndryshme të videos, të  
4 katërta të tyre.

5 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Atëherë këtu  
6 bëhet fjalë për 067205-01 apo jo?

7 Z. PACE: [Përkthim] Po, i nderuar, saktë.

8 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Dhe ju çfarë  
9 dëshironi?

10 Z. PACE: [Përkthim] Minuta 8:15 deri në 11:28 si edhe  
11 katër fotografitë që u bënë, tre në fakt të tyre.

12 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] A ka  
13 kundërshtime?

14 Z. KEHOE: [Përkthim] Nuk ka kundërshtim nga ana jonë.

15 Z. ROBERTS: [Përkthim] Nuk ka kundërshtim nga ana jonë.

16 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Z. Ellis.

17 Z. ELLIS: [Përkthim] Jo, asgjë i nderuar.

18 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] [Mikrofoni  
19 çaktivizuar]

20 067205-01 pranohet, duke përfshirë edhe tre fotografitë që  
21 iu bënë videos në momente të caktuara dhe ato do të marrin  
22 edhe numra përkatës për si provë materiale.

23 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Të nderuar, video  
24 067205-01 nga minuti 08 e 15 sekonda deri 11:28 do t'i jepet  
25 numri si provë P727 dhe tre fotografimet që u bënë do të quhen

1 prova materiale P728, të nderuar.

2 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faleminderit.

3 Z. PACE: [Përkthim] Faleminderit, Sekretare e Seancës  
4 edhe ju i nderuar.

5 PY. Edhe Dëshmitar, dëshiroj që t'i kthehem diçkaje që ju  
6 thatë më herët dhe në fakt është në transkriptin, në  
7 procesverbalin e ditës së sotme.

8 Për Jakup Muharremi po flitej dhe ju tha vetë ai apo  
9 mësuat disi për ndokënd tjetër që ka qenë i përfshirë në  
10 keqtrajtimin ose mbajtjen e Jakup Muharremi.

11 Dhe ju thatë:

12 "Jo. Jakupi ma ka thënë vetë, drejtpërsëdrejti mua  
13 personalisht".

14 Dhe pastaj folëm për përfshirjen e Skënder Hoxhës në  
15 keqtrajtimin e Jakup Muharremi dhe pyetja ime është: A dini  
16 që ndokush tjetër, përveç Skënder Hoxhës, që të ketë qenë i  
17 përfshirë në keqtrajtimin e Jakup Muharremi?

18 PË. Sipas Jakupit që më ka thënë ka qenë edhe Sabahudin Cena  
19 i përfshimë. Po më ka ardhë e çuditshme një akademik të  
20 përfshihet në një veprim të ulët e pakuptimtë. Megjithatë, jam  
21 shumë i sigurt që kam bisedu me Jakupin disa herë këtë punë,  
22 sepse kemi relacione familjare; ne kemi një lidhje gjaku,  
23 farefisnore.

24 PY. Dëshmitar, do të ndërrojmë temë tani. Në qershor të vitit  
25 '99 pas çlirimit, UÇK-ja a ka patur kontroll të qytetit të



1 Suharekës?

2 PË. Edhe një herë, ju lutem, Prokuror?

3 PY. Patjetër. Në qershor të viti 1999 pas çlirimit, a e  
4 kishte UÇK-ja nën kontroll qytetin e Suharekës?

5 PË. Jo. Pas lufte ka hy KFOR-i, kuptohet me hymjen e KFOR-it  
6 është edhe liria e Suharekës, liria e Prizrenit, gjithë  
7 Kosovës. Por megjithatë ka pasur UÇK në Suharekë.

8 PY. Në qershor të vitit 1999 a ka patur prani të UÇK-së në  
9 stacionin e policisë në Suharekë?

10 PË. Po ka filluar të funksionojë si polici ushtarake që ka  
11 qenë, policia në stacionin e ish-policisë të Serbisë në  
12 Suharekë.

13 PY. Faleminderit.

14 Z. PACE: [Përkthim] Znj. Sekretare e Seancës kërkoj që në  
15 ekran të vendosen përbri njëra-tjetrës U001 [sipas përkthimit]  
16 -8743 deri në U001-8707 [sipas përkthimit] dhe 8935-ET *Revised*  
17 1. Ju lutem, që të kemi faqen e parë tashmë që ta shikojmë.

18 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] A mund të na sqaroni,  
19 sepse në radhë kemi një version më të gjatë dhe një version të  
20 shkurtuar. Cilin dëshironi?

21 Z. PACE: [Përkthim] Versionin e gjatë. Pra, në shqip  
22 bëhet fjalë për një libër dhe janë pjesë të tij të cilat janë  
23 pranuar për Gjykatën dhe në anglisht bëhet fjalë për numrin  
24 8743 deri në 8935.

25 PY. Faleminderit.

1 Dëshmitar, duke u përqendruar te imazhi në të majtë, ju a  
2 e njihni këtë libër? E keni parasysh se çfarë është?

3 PË. Po. Këtë libër e kam lexue pasi ka dalë në publik, pasi  
4 është promovuar është "Kthesa e Madhe", libri i Jakup  
5 Krasniqit. Nga ky libër kam marrë disa emna, që i përmban ky  
6 libër, të familjes Jashari dhe i kam edhe në librin tim ata  
7 emra, të viktimave Jasharaj.

8 Z. PACE: [Përkthim] Znj. Sekretare e seancës, a mund të  
9 kalojmë te faqja 8849 edhe në shqip edhe tek përkthimi  
10 përkatës në anglisht. Nuk e di nëse ju ndihmon, por faqja në  
11 libër është 106. Në fakt është faqja tjetër, jo kjo faqja. Po,  
12 në anglisht e kemi të saktë.

13 PË. Tani, Dëshmitar, unë do të lexoj një pjesë nga libri në  
14 anglisht që është në të djathtë; në shqip do të jetë e njëjta  
15 pjesë. Ja ku e kemi. Do të filloj të lexoj nga pjesa që thotë  
16 "Nënzona Operative e Pashtrikut".

17 Z. PACE: [Përkthim] Dhe Sekretares së seancës i kërkoj që  
18 siç ka bërë edhe më parë të vijojë me faqen tjetër kur të  
19 vazhdojmë se do të vazhdojmë me faqen 8851.

20 PY. Pra, Dëshmitar, unë do të lexoj si fillim dhe më pas do  
21 t'ju bëj pyetje.

22 "Nënzona Operative e Pashtrikut fillimisht përfshinte  
23 territorin e këtyre komunave: Prizren, Sharr, Rahovec,  
24 Suharekë (Therandë) dhe Malishevë. Edhe në këtë nënzonë  
25 organizimi i Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës është bërë në bazë

1 të njësiteve për të kaluar më vonë në formacione ushtarake.

2 Brigada ishte formacioni më i madh ushtarak.

3 Në këtë nënzonë, bazat e para dhe më të fuqishme të UÇK-  
4 së ishin në komunën e Rahovecit, Drenoci i Zatriqit, Zatriqi  
5 dhe fshatrat e Maleve të Berishës: Kleçkë, Divjakë etj. Pas  
6 mbylljes së Grykës së Llapushnikut, qendër e rëndësishme jo  
7 vetëm për nënzonën e Pashtrikut, bëhet Malisheva ku ishte  
8 vendosur edhe komuna e nënzonës me komandant Musë Jasharin. Në  
9 këtë kohë UÇK-ja me të shpejtë fillon të...", dhe ju lutem të  
10 vijojmë me faqen tjetër.

11 "... të shtrihet në Suharekë me udhëheqës Blerim Kuçin,  
12 Sadik Halitjahën [sipas përkthimit] i cili pas ofensivës së  
13 verës së '99 [sipas përkthimit] largohet në Shqipëri dhe i  
14 bashkëngjitet një grupi të dezertorëve të UÇK-së etj. Kurse  
15 për organizimin e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës me Vrrinën  
16 dhe rrethinën u ngarkua Remzi Ademi nga Zhuri. Kur u bë  
17 strukturimi i Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës në këtë nënzonë  
18 kishte 5 brigada të cilat ishin: Brigada 121 shtrihet nga  
19 Llapushniku deri në Duhel, duke përfshirë të gjithë fshatrat të  
20 shtriheshin përreth Maleve të Berishës; Brigada 122 përbëhej  
21 nga fshatrat përreth Malishevës; Brigada 123 shtrihej në  
22 komunën e Suharekës; Brigada 124 përfshinte Rahovecin dhe  
23 fshatrat përreth; dhe Brigada 125 këtu bënin pjesë fshatrat e  
24 Vrrinit dhe shtrihej deri në Prizren.

25 Një karakteristikë dalluese e kësaj zone ishte përfshirja

1 e elementëve intelektualë ku një rol dallues e kanë pasur ish  
2 të burgosurit politik. Pas ofensivës së verës '98 prej  
3 brigadave të përmendura, shthurje më të madhe pësuan Brigada  
4 123 për shkak të dezertimit të komandantit Blerim Kuçi dhe një  
5 pjesë të komandës dhe infiltrimit të elementit FARK-ist i cili  
6 edhe pas konsolidimit do të jetë prezent dhe vazhdimisht e  
7 dobësoi organizimin luftarak...".

8 Z. PACE: [Përkthim] Po, do të -- nuk do të flas me kaq  
9 shpejtësi. Shpresoj që përkthyeset mos ta kenë patur shumë të  
10 vështirë.

11 PY. "... shthurje më të madhe, pra, pësuan këto si dhe  
12 Brigada 125. Kjo e dyta pësoi edhe për shkak të goditjeve që  
13 mori nga armiku, fillimisht duke u vrarë në pusi komandant  
14 "Petriti", Remzi Ademi, por edhe për shkak se brigada po  
15 vepronte e izoluar, sepse, vepronte mjaft e izoluar, se nuk  
16 kishte lidhje fizike me hapësirën tjetër të nënzonës. Derisa  
17 Brigada 124 pikën më të dobët të saj e kishte në batalionin që  
18 e ofronte në Sverkë të Gashit ku elementi FARK-ist ishte mjaft  
19 i rebeluar ndaj komandës së brigadës, por mjerisht jo edhe aq  
20 e vendosur ndaj armikut".

21 "Nga fundi i vitit 1998 pasi Musë Jashari shkon në detyrë  
22 tjetër për komandant të nënzonës do të emërohet Ekrem Rexha,  
23 me pseudonimin e luftës "Drini" i cili pas lufte në rrethana  
24 ende të pasqaruara vritet. Kur është marrë vendimi për të  
25 shkuar në Rambuje prononcimi i këtij ka qenë pro shkuarjes. Në

1 fillim të vitit 1999 ky do të shkojë në detyrë të re”.

2 Duhet të kalojmë te faqja tjetër dhe edhe pak më ka  
3 mbetur për të lexuar.

4 “... Komandanti i shkollës për komandim e stërvitje,  
5 ndërsa komandanti i brigadës emërohet Tahir Sinani. Kjo  
6 gjendje ka mbetur deri në fund të luftës.

7 Me vendimin e SHP-së të UÇK-së dhe nën udhëheqjen e  
8 Drejtorisë Operative në këtë zonë ka qenë e organizuar shkolla  
9 e oficerëve për komandantë të batalioneve. Kanë dalë disa  
10 gjenerata nga kjo shkollë. Shumë prej tyre janë edhe oficerë  
11 të TMK-së. Shkollën e kurseve e ka udhëhequr Sali Veseli,  
12 major i ish AJ-së i cili dha një kontribut të çmuar në luftën  
13 çlirimtare. Tani vazhdon kontributin e tij si oficer i lartë i  
14 Trupave Mbrojtëse të Kosovës”.

15 Dëshmitar, unë po ndaloj këtu dhe pyetja ime për ju  
16 është: Duke patur parasysh pozicionet që ju keni pasur në '98  
17 dhe '99 tek UÇK-ja, me sa dini ju informacioni që ju kam  
18 lexuar dhe ishte dhe në ekran, a ishte i saktë?

19 PË. Simbas kësaj që shifet në librin e Jakup Krasniqit  
20 “Kthesa e Madhe”, informacionet janë të sakta. Nuk kam çka i  
21 shtoj. Përpos nuancave ndoshta ai i ka pa pak më ndryshe.

22 PY. Ne dëgjuam që në këtë fragment jemi referuar një vendimit  
23 të AJ-së për një shkollë për sa i përket për të bërë, pra, një  
24 kurs për komandantët e batalioneve. Me ç'dini ju, a u krijua  
25 kjo shkollë e oficerëve?

1 PË. Po, e biseduam edhe seancën tjetër më herët, ky kurs ka  
2 vazhdu dikun nga mesi i shkurtit 1999 deri në mesin e marsit  
3 1999. Domethënë, një muaj apo 5 javë me oficerët me  
4 komandantët e batalioneve siç e thamë edhe më parë.

5 PY. Dhe përveç këtij kursi ka patur një shkollë për  
6 komandantët e batalioneve të përhershme apo ka qenë vetëm një  
7 kurs *ad hoc* ky?

8 PË. Jo, është mendu të krijohet akademia e shkollave  
9 ushtarake në nivel të Kosovës, në nivel të Shtabit të  
10 Përgjithshëm. Po ajo ka mbet veç si dëshirë, përndryshe ka  
11 qenë komandant "Drini", Ekrem Rexha i emëruar komandant i asaj  
12 akademia të shkollave ushtarake. Ka mbet vetëm si tentativë.

13 Z. PACE: [Përkthim] I nderuar Gjyqtar, ne kërkojmë  
14 gjithashtu që faqet që i kemi treguar dëshmitarit si në  
15 anglisht ashtu edhe në, shqipja, origjinale dhe përkthimi në  
16 anglisht të pranohet që nga faqja 849 deri në 851 [sipas  
17 përkthimit].

18 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Pra, 8849  
19 deri në 8851. Dhe do të përdorim formatin e zgjatur apo të  
20 shkurtuar? Mund të vijojmë me të. Zgjidhni cilin dëshironi  
21 prej këtyre të dyjave.

22 [Trupi Gjykses dhe Sekretarja e Seancës  
23 këshillohen]

24 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Të nderuar, faqet e  
25 identifikuara do të pranohen si Prova Materiale P729.

1 Faleminderit.

2 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faleminderit.  
3 Vazhdoni, z. Pace.

4 Z. PACE: [Përkthim] Faleminderit, i nderuar.

5 Z. KEHOE: [Përkthim] Një gjë për sqarim, ju lutem.

6 Ka edhe disa faqe të më përparshme, qoftë përpara qoftë  
7 më pas. Pra, do të pranohen vetëm ato që u lexuan nga  
8 Prokuroria apo jo?

9 Po, e di, por ka pasur informacion si përpara ashtu edhe  
10 pas atyre faqeve dhe besoj se Prokuroria kërkon që të pranohen  
11 vetëm ato që janë lexuar.

12 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Pra, e vetmja  
13 gjë që do të pranohet janë ato faqe që u lexuan apo jo?

14 Z. PACE: [Përkthim] Po, i nderuar Gjyqtar. Për shembull,  
15 ato paragrafë që kemi për shembull në fillim të faqes si edhe  
16 në fund. Si të preferohet, natyrisht.

17 Z. KEHOE: [Përkthim] Gjyqtar, thjesht po përpigemi që të  
18 sqaroj situatën.

19 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Po e kuptoj.  
20 Varet prej tërë jush. Z. Pace.

21 Z. PACE: [Përkthim] Po, mund të pranojmë pjesët që u lexuan  
22 ose mund të kemi një paragraf që filloi të lexohej pak më  
23 përpara se ai. Por mund të jetë më e lehtë që t'i pranojmë të  
24 gjitha faqet nga fillimi deri në fund.

25 PY. Faleminderit, Dëshmitar. Nuk kam më pyetje të tjera.

1 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Gjykatësi

2 Mettraux ka një pyetje.

3 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Kam një pyetje për ju z.

4 Pace. Nuk e di në qoftë se mund të kontrolloj, nuk është e

5 nevojshme që të jetë tani, ta bëni tani, por bëhet fjalë për

6 Proven Materiale P718. Duket sikur ju keni ofruar si provë

7 tani vetëm U001-2314, por ky është dokumenti i cili zgjat edhe

8 dy faqet e tjera. Thjesht doja që ta sqaronim. E thashë,

9 domethënë, që nuk është e nevojshme ta shihni tani, nuk është

10 çështje urgjente, por thjesht shiheni dhe mbase mund të na

11 thoni nesër në qoftë se doni që të pranohet në një faqe apo në

12 dy faqe ky dokument. Besoj se është pranuar si provë në

13 dokument F1901.

14 Z. PACE: [Përkthim] Faleminderit. Do ta shikoj e do t'ju

15 them.

16 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Z. Emmerson e

17 keni ju fjalën. Përgatituni pa problem.

18 Z. EMMERSON: [Përkthim] Më shumë zhurmë, sesa shpejtësi.

19 Pyetje të palës tjetër nga z. Emmerson:

20 Z. EMMERSON: [Përkthim]

21 PY. Z. Halitjaha, do t'ju bëj disa pyetje në emër të Kadri

22 Veselit. Unë do të bëj pyetjet i pari, pastaj Avokati i z.

23 Thaçi, z. Selimi dhe z. Krasniqi do të kenë sipas rendit

24 mundësinë që t'ju bëjnë pyetje pak më vonë gjatë javës, me

25 ç'kam kuptuar.



1 Nëse më lejoni dua që të fillojmë, duke dhënë ca data  
2 konkrete, të qarta rreth tri fazave të ndryshme të shërbimit  
3 tënd të njohur në Ushtrinë Çlirimtare të Kosovës. Arsyeja  
4 është shumë e rëndësishme, sepse kur shohim disa prej dëshmive  
5 që keni dhënë për Prokurorinë ose disa prej të dhënave që keni  
6 dhënë në librin që keni shkruar sa i takon çështjeve  
7 organizative të UÇK-së për ne është shumë e rëndësishme që të  
8 dimë ekzaktësisht se kur në periudhën nga janari 1998 deri në  
9 nëntor/dhjetor 1999-s, pra, cila është kjo periudhë që  
10 përshkruani juve qoftë në dëshminë e dhënë, por edhe në librin  
11 e shkruar?

12 Do filloj me tri fazat. Pra, dua që të përcaktoni qartë  
13 këto tri faza. Besoj që ju thatë që keni ardhur në Kosovë,  
14 keni mbërritur në Kosovë më 9 qershor 1998, a është e saktë  
15 kjo z. Halitjaha?

16 PË. Jo, me 7 qershor 1998.

17 PY. Me 7. Ju kërkoj ndjesë.

18 Po, absolutisht është shumë e rëndësishme që të jepni  
19 informacion të tillë të saktë. Me datë 7 keni ardhur në Kosovë  
20 atëherë. Ju keni pas një lloj trajnimi ushtarak vetë apo jo?

21 PË. Vetë po. I trajnum dhe i shkollum në atë drejtim. Kam  
22 lexu shumë literaturë ushtarake, sepse jam konë i organizum  
23 nga 1977; i organizuar në drejtim të luftës. 10 vite para  
24 lufte kam qenë në Shqipëri dhe kam qëndruar më shumë se 5  
25 muaj, rreth 6 muajve.

1 PY. A keni kaluar ndonjë trajnim ushtarak në Shqipëri, ndonjë  
2 stërvitje ushtarake?

3 PË. Jo, përpos literaturës jo, ushtrime vetanake.

4 PY. Kur keni shkuar në Kosovë, kur u futët në Kosovë, sa për  
5 t'i sqaruar gjërat siç duhet; nëse mund të shprehem kështu,  
6 detyra jote e parë ka qenë në Budakovë kur jeni fut në Kosovë  
7 apo jo?

8 PË. Po. Ashtu është.

9 PY. Kur mbërritët në Budakovë, menjëherë ju dha një titull,  
10 ju dha titulli si komandant?

11 PË. Jo, nuk ka shku në atë [e pakuptueshme] se s'ka pasë  
12 struktura të mëhershme për me na dhonë tituj dhe vendime.  
13 Strukturat kanë qenë shumë në embrion, të paorganizume, një  
14 grupim i vogël që kishte dalë më herët në fshatin Dobërdolan.  
15 Ndërsa në Budakovë kam shku me tre ushtarë dhe kam arrit t'i  
16 bëj 20 për betejën e parë që kam zhvillu me 3 korrik.

17 PY. A e kuptoj drejt që kur shkove në Budakovë atje ishe  
18 vetëm ti vetë edhe tre veta të tjerë që identifikoheshit si  
19 UÇK.

20 PË. Po.

21 PY. Kur thoni që arritët që të mblidhnit 20 ushtarë të tjerë  
22 që të bëheshit gati për betejën e parë, a e keni fjalën për  
23 betejën e Rahovecit që ka ndodhur me 17 korrik?

24 PË. Jo. Beteja në Budakovë. Ka ndodhë me 3 korrik dhe 4  
25 korrik.

1 PY. Shumë mirë. Pra, mund ta themi kështu besoj që në më pak  
2 kohë sesa një muaj ju patët mundësi që të mblidhnit bashkë  
3 rreth 20 ushtarë apo jo?

4 PË. Po. Pas kësaj date nuk më ka vyrt shumë edhe tri javë të  
5 tjera kam bë 583 ushtarë, luftëtarë, ushtarë s'kanë qenë,  
6 luftëtarë. Se ushtri e kuptoj me qenë e rregullt. Këta kanë  
7 qenë vullnetarë.

8 PY. Kjo do ishte dhe pyetja ime tjetër dhe për këtë dua t'ju  
9 bëj disa pyetje tani. Dua që të jeni sa më i qartë të jetë e  
10 mundur, sepse në përgjigjen që dhatë më herët kam përshtypjen  
11 që ju thatë që arritët që të mblidhnit së bashku 20 ushtarë  
12 për betejën e parë. Është keqkuptim ky apo jo, sepse pak më  
13 poshtë ti thua që ishin luftëtarë, por goxha më tepër, por ju  
14 thatë ishin luftëtarë jo ushtarë.

15 PË. Luftëtarë-vullnetarë duhet, kështu më drejtë është.  
16 Luftëtarë-vullnetarë. Jo ushtarë, se ushtri ka kuptimin e  
17 klasifikimit të ushtrimit, kazermimit të rregull, nuk ka pasun  
18 diçka të tillë. Ka qenë vullnetare.

19 PY. Që të jemi të qartë, po thoni që deri në kohën kur  
20 arritët në javën e parë të korrikut kishit arritur që të  
21 mblidhnit bashkë 20 ushtarë apo 583? Ju kërkoi ndjesë ë,  
22 ndoshta duket një pyetje e thjeshtë edhe duket sikur e  
23 sqaruat, por thjesht po kuptojmë që po mundohem që të kuptoj  
24 pak më mirë shifrat. Mund të na e shpjegoni edhe një herë?

25 PË. Mund të flasim. Thashë deri në fund të korrikut,

- 1 domethënë, për tri javët e pastajme, pas betejave, u  
2 grumbulluam vullnetarë dhe u bënë 583 luftëtarë. Qartë?  
3 PY. E kuptoj, qartë. Pra, në fillim mblodhët 20 luftëtarë-  
4 vullnetarë dhe pastaj deri nga fundi i korrikut, nga fillimi i  
5 gushtit numrat u rritën shumë-shumë, domethënë, disa dhjetëra  
6 herë u rritën deri në fund të korrikut.
- 7 PË. Po, për shkak të suksesit të betejave. Për shkak se 3  
8 korriku dhe 4 korriku ishin beteja të suksesshme, ku ne  
9 dominum, ne fitum dhe kjo e bëri shumë që të vijnë vullnetarë  
10 rreth nesh.
- 11 PY. Sepse kjo dha sinjalin e mundësisë edhe të moralit apo  
12 jo?
- 13 PË. Ashtu është.
- 14 PY. Atëherë mendoj që morali ishte një prej pikave tuaja të  
15 fortave apo jo? E kam të drejtë këtë?
- 16 PË. Një prej kryesorëve.
- 17 PY. A kam të drejtë të them që thujse që të gjithë e dinin,  
18 edhe në qoftë se nuk e dinin e mësuan shumë shpejt që ju ishit  
19 një prej atyre personave që kishit qenë në burg dhe ishit  
20 torturuar nga serbët apo jo?
- 21 PË. Po, me siguri, ashtu është.
- 22 PY. A ju dha kjo gjë ju një lloj kompetence, besueshmërie,  
23 besueshmërie ose respekti sa i takon oponentëve afatgjatë të  
24 Serbisë?
- 25 PË. Jo. Më tepër vendosmëria ime për luftën dhe trimëria në

1 luftë kanë pas në efekte.

2 PY. Dhe nga këta 583 vetë sa prej tyre kishin ushtarë [sipas  
3 përkthimit]? Ose ta bëj ndryshe pyetjen: sa armë kishte në  
4 dispozicion të këtyre 583 vetëve? Përafërsisht.

5 PË. Fillimisht nuk kanë pasë armë të gjithë, fillimisht nuk  
6 kanë pasë armë të gjithë. Kanë ndodh që dy kanë pas armë, një  
7 s'ka pasë. Dikur më vonë jemi armatosur më mirë me armë të  
8 lehta, mitraloz, topa pa dridhje, 75 milimetra, mortaja krahu,  
9 kemi pasë armë që për këmbësorinë e armikut kanë qenë të  
10 mjaftueshme.

11 PY. Ky është një ilustrim shumë i mirë i asaj çfarë po thoja  
12 unë në fillim. Çfarë do të thotë që në qoftë se do shohim një  
13 kohë të caktuar në të shkuarën është e rëndësishme që të mos  
14 flasim për atë se çfarë ka ndodhur më pas në qoftë se nuk e  
15 ilustruam ose në qoftë se nuk japim hollësi lidhur me kohën  
16 për të cilën po flasim. Kështu që duhet bërë e qartë faza për  
17 të cilën po flasim kur japim hollësi.

18 Pyetja për ju është kjo: Në atë fazë, pra, duke filluar  
19 nga korriku dhe deri në fund të korrikut, a kishit të gjithë  
20 luftëtarët armë ose cila është përqindja e luftëtarëve që  
21 kishin armë gjatë asaj kohe? Kam fjalën për qershorin,  
22 korrikut e 1998, Dëshmitar.

23 PË. Nga 26 qershori, themelimi i Batalionit të 2-të në  
24 Budakovë deri në fund të korrikut kanë qenë 70 për qind të  
25 armatosur. Nëse e marrim me përqindje. Pastaj kanë qenë 90 për

1 qind.

2 PY. Batalioni i 2-të kur është formuar, në çfarë date, për ta  
3 sqaruar?

4 PË. Më 26 qershor 1998.

5 PY. Kur është formuar ju a u bëtë menjëherë komandant i atij  
6 batalioni?

7 PË. Po. Unë isha komandanti i batalionit që në themelim,  
8 sepse isha edhe themeluesi.

9 PY. Kur thoni që kur mbërritën strukturat e batalionit dhe  
10 brigadave të tjera nuk ishin krijuar akoma, e keni fjalën për  
11 formimin ose formacionin që ndodhte nën frymëzimin dhe  
12 udhëheqësinë tuaj, për këtë e keni fjalën?

13 PË. Strukturat janë bërë më vonë dhe nuk ka pasur të  
14 strukturuar edhe batalione por as brigada. Një prej  
15 strukturave të para Batalioni i 2-të është në komunën e  
16 Suharekës.

17 PY. Ju thatë se këta njerëz ishin luftëtarë-vullnetarë.  
18 Domethënë, e kam fjalën fillimisht për 20 vetët dhe pastaj 500  
19 e ca vetët. Ju lutem, a mund t'i shpjegoni Trupit Gjykues se  
20 çfarë nënkuptoni kur thoni "vullnetarë" kur thoni që kanë qenë  
21 "luftëtarë-vullnetarë", çfarë nënkuptoni me këtë?

22 PË. Unë shpresoj se edhe Trupi Gjykues edhe Kryetari i  
23 Gjykatës e kupton edhe e din se çfarë do të thotë "vullnetar"  
24 dhe çfarë do të thotë "ushtar i rregullt". Vullnetarët nuk  
25 mobilizohen me letërthirrje, nuk iu përgatitet paraprakisht

1 arma, uniforma, vendi ku duhet të shkojë dhe të obligohet të  
2 shkojë. Ndërsa ushtarët e rregullt janë të kazermuar, ata kanë  
3 uniformë paraprakisht, i kanë armët dhe kanë urdhrat e  
4 caktuara se nga duhet të lëvizin dhe ku duhet të shkojnë.

5 Dallimi i madh është mes asaj vullnetare dhe asaj e  
6 organizume shtetnore.

7 PY. Për shembull, në këtë fazë, vullnetarët a kërkohej që  
8 gjithmonë të ishin në shërbim 24 orë në ditë ose duhet të  
9 ishin alert, a duhet të ishin gati gjatë gjithë kohës apo në  
10 sa operacione iu kërkohej që të ishin të pranishëm e ca të  
11 tjera jo, si funksiononte ky element?

12 PË. Varësisht nga situatat. Në situata të ofensivave, jo veç  
13 24 orë, por po ndoshta dhe shumë më shumë. Në situata të geta  
14 ata kanë mujt me lëviz edhe në vizita familjare me shku edhe  
15 me konë më të lirë. Sidomos situatat e ofensivave të luftës  
16 janë konë të pashkëpuetshëm. S'kanë pasë mundësi.

17 PY. Në librin që keni shkruar e keni përshkruar UÇK-në si të  
18 ngjashme me një organizatë partizane të llojit që luftonte  
19 kundër pushtuesve në Luftën e Dytë Botërore. A është përshkrim  
20 i saktë ky?

21 PË. Jo, nuk është kjo kështu. Është se ka pasë tipare të  
22 vetive të luftës partizane. Domethënë, ka marrë, ka marrë disa  
23 mësim nga mënyra e luftës partizane, jo si partizane. Sepse  
24 UÇK-në nuk e ka udhëheq ndonjë parti politike dhe UÇK-ja nuk  
25 ka pas ngjyrimë ideologjike, por ka qenë vetëm kombëtare.

1 Qartë?

2 PY. Por mënyra sesi e përshkruani në librin tuaj dhe do  
3 shikojmë pjesë të tij më vonë është e tillë që strategjia e  
4 UÇK-së ishte që të përqendrohej ose në akte të caktuara  
5 sabotimi në raste të caktuara ose si fillim, ose që të  
6 tërhiqte armiqtë në fusha të caktuara ose sulme të caktuara  
7 dhe të mos hapte sulme të gjëra për armikun. Kështu e  
8 përshkruani juve.

9 Z. PACE: [Përkthim] I nderuar Gjykatës, kërkojmë kohën në  
10 referencën e kohës dhe gjithashtu dëshiroj që të lexojë apo të  
11 citojë pjesën përkatëse në librin e dëshmitarit.

12 Z. EMMERSON: [Përkthim] Po, patjetër do shikojmë te libri  
13 por thjesht dua që ta sqaroj këtë pikë me dëshmitarin.

14 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Mund të  
15 vazhdoni.

16 Z. EMMERSON: [Përkthim]

17 PY. A e kuptova drejt apo jo, të paktën nga ajo çfarë kam  
18 lexuar nga libri?

19 PË. Jo, nuk e keni thënë drejt se kishte strategji  
20 sabotazhesh çfarë thatë ju. Por kishte strategji vërtet me e  
21 godit armikun dhe ta tërheqë në pozita ku armiku nuk mund të  
22 të lëvizte me makineri të rëndë dhe aty të goditej se  
23 barazohej, barazimi i luftës bëhej, derisa ata nuk mundnin të  
24 depërtonin me tanksa, përpos me helikopter me avion. Ne mund  
25 ta bënim luftën këmbësori me këmbësori dhe kjo ishte



1 strategjia jonë, t'i nxjerrim nëpër kodra, nëpër vende malore,  
2 nëpër vende ku nuk mundet atëherë të rezistonin. Kështu.

3 PY. Pra, artileria e rëndë nuk shërbente në këtë pikë,  
4 kështu? Ose shërbente më pak, në qoftë se mund të shprehesha  
5 kështu.

6 PË. Artileria e rëndë shërbente nga distanca kur rrafshonte  
7 pozicionet tona, dëmtonte UÇK-në, por në depërtim në thellësi  
8 në vendet malore, në rrugët zigzage nuk mund të depërtonin  
9 tanksat se ishin të rënda. Edhe ne derisa mund ta godisnim  
10 tanksin e parë qëndroshim në baraspeshë luftarake.

11 PY. Shumë mirë. Atëherë periudha e parë e përfshirjes tuaj  
12 personale zgjat nga data 7 qershor kur hyni në Kosovë me 26  
13 qershor kur ju bëheni komandant i batalionit me seli në  
14 Budakovë. Dhe besoj që është e drejtë të themi që e pranoni  
15 apo jo që UÇK-ja në të gjithë Kosovën ishte e mundur nga  
16 ofensiva e verës e Serbisë deri në atë pikë që në mënyrë  
17 serioze ishte e reduktuar në kapacitetin e vet deri në  
18 shtator. Domethënë, kapaciteti i saj ishte ulur ndjeshëm deri  
19 në shtator si rezultat i sulmeve serbe?

20 PË. Me rëndësi është të fitohet lufta. Ka pasë beteja të  
21 tilla që është mund UÇK-ja. Sidomos betejat e gushtit me 21-  
22 22-23-24-25 gusht thyhen disa vendqëndrime disa pika të  
23 rëndësishme të UÇK-së dhe në këtë kohë bëhet dezertimi i madh  
24 në Dukagjin nga Tahir Zema me brigadën e vet. Njëkohësisht  
25 dezertimi i komandës në Suharekë. Mirëpo, UÇK-ja si e tillë

1 ishte 70 për qind akoma në male dhe ishte duke u  
2 ristrukturuar.

3 PY. Ju thoni që kishte më pak njerëz UÇK-ja; më pak pjesëtarë  
4 UÇK-ja deri në njëfarë mase, por ato ishin në pjesë të  
5 ndryshme të vendit apo jo? Domethënë, nuk është se ishin siç  
6 duhet të organizuar në Shtator, a është e saktë kjo?

7 PË. Unë flas për pozicionet e mia. Aty nuk janë zvogëlu numri  
8 i ushtarëve në ato kohë, por janë rritur. Edhe ata që kanë  
9 lëshu pozicionet e veta kanë ardhë tek unë, kanë ardhë edhe  
10 armë të tjera që kanë mbet të tepërta që kanë lënë ushtarët,  
11 kështu që unë kam qenë më i fuqishëm nga ajo betejë e mbrapa.

12 PY. Kur përshkruani organizimet operative në zonën tuaj si  
13 pikat e një leopardi a mund t'ia shpjegoni Trupit Gjykues se  
14 çfarë doni të thoni me këtë krahasim, me këtë analogji? Si ta  
15 kuptojmë këtë krahasim?

16 PË. Me kënaqësi do ta shpjegoja po ta kem hartën këtu  
17 përpara, sepse logjikshëm besoj që edhe Gjykatësi, Kryetari i  
18 Kolegjit të Gjykatës edhe Gjykatësit e tjerë do ta kuptojnë se  
19 rrugët kryesore, rrugët principale, qytetet, kazermat dhe  
20 vendet kyçe kanë qenë të kontrolluara nga forcat e armikut dhe  
21 forcat e armikut kanë pas në dorë dhe në mundësi të tyre edhe  
22 civilët shqiptarë. Kjo ka kuptimin se bëhet si larat e  
23 leopardit që si lëkura e leopardit.

24 PY. Mendoj se do të vazhdoni dëshminë tuaj edhe për disa ditë  
25 të tjera edhe do sigurohemi që të keni një hartë përpara,

1 përpara se të përfundojmë me pyetjet. Megjithatë, a po flisni  
2 për një hartë që mbulon gjithë zonën e Kosovës apo po flisni  
3 vetëm thjesht për zonën përreth Kleçkës, Budakovës, Rahovecit  
4 dhe ato zonat përreth? Çfarë lloj harte do ju ndihmonte juve  
5 për të na përshkruar më mirë këto larat e leopardit që thatë?  
6 PË. Ato që po kërkoni ju unë edhe po t'jua shpjegoj tash  
7 figurativisht me duart e mia e me gjeste edhe një fshat qoftë  
8 edhe tre fshatra nuk do ta kuptoni se nga kanë qenë ndarjet me  
9 pozicione. Këtë po e them se rrugët principale, rrugët  
10 kryesore, qytetet, ndarja e pjesëve që ka dominue forcat serbe  
11 e kanë shkëput UÇK-në nëpër majat e ndryshme të natyrës që ka  
12 qenë pjesë-pjesë, domethënë e shkëputur, nëpër pjesë të  
13 ndryshme, s'ka mund --

14 Një shembull po ta them, nëse më lejon Gjykatësi se po  
15 bëna i tepërt. Unë, për shembull, si zëvendëskomandant zone  
16 asnjëherë nuk kam mund të dal në Vrrin ose në Kabash ose në Has  
17 se s'kam mund të kaloj Prizrenin, s'kam mund t'i kaloj rrugët  
18 kryesore për t'u taku me njësitet e mia. Ose komandanti i  
19 Brigadës 125 ka pas 3 batalione. Ai ka pasë me vete vetëm  
20 njërin batalion; të tjerët i ka mbajtur me korrierë, s'ka mund  
21 për shkak të situatave që janë konë ndërprerjet prej forcave  
22 serbe të kontaktojë. Më duket e keni të qartë tash.

23 PY. E bëtë të qartë dhe siç e thashë do sigurohem që do t'ju  
24 japim një hartë të përshtatshme në momentin kur do t'ju bëj  
25 pyetje përsëri lidhur me këtë çështje.

1 Megjithatë, ajo çfarë po thoni mendoj dhe më korrigjoni  
2 në qoftë se e kam gabim, është që komandanti mund ta gjente  
3 veten në një situatë që fizikisht të ishte i veçuar, të ishte  
4 i ndarë nga ushtarët që ishin në komandën e vet që bënë pjesë  
5 në njësit tjetër ose një grup tjetër luftarak që s'ishte me  
6 komandantin. Dhe ju mund të ndaheshit nga rrugë ose territore  
7 të cilat kontrolloheshin nga forcat serbe. A e kam kuptuar  
8 drejt, Dëshmitar?

9 PË. Nuk mund të gjindej vetëm, vetëm nëse ka dezertuar ka ik,  
10 përndryshe gjithmonë e ka pas njësinë e caktume. Zakonisht në  
11 rregullat ushtarake komandanti i brigadës, komandanti i  
12 brigadës rrinë me batalionin e parë më afër komandës. Me të  
13 tjerët i mban lidhjet në mënyrat e ndryshme.

14 Ndërsa i vetëm po të jetë pa ushtarë nuk është diçka në  
15 rregull. E kuptoj kështu.

16 PY. Jo nuk e thashë kështu. Mbase nuk e kam shprehur mirë.  
17 Nuk po them që komandanti i brigadës gjendej i vetëm, por ajo  
18 çfarë po them unë, çfarë po sugjeroj është që një komandant  
19 brigade ose batalioni a e kuptoi drejt atë që thatë ju, që  
20 vetë komandanti mund të ishte në një prej larave të leopardit,  
21 ndërkohë që ushtarët e tjerë në komandën ose kompetencën e tij  
22 mund të ishin në një larë tjetër të leopardit. A e kuptova  
23 drejt?

24 PË. Tash është korrekt. Tash është korrekt.

25 PY. Dhe ndërmjet këtyre tani i takon që territori të jetë, të

1 ketë qenë tërësisht i kontrolluar nga serbët, nga forcat  
2 serbe. Domethënë e kam fjalën këtu për rrugët kryesore.  
3 PË. 80 për qind, 80 për qind e territorit, 80 për qind e  
4 territorit, më shumë.  
5 PY. Pra, kishte xhepa ose lara mbështetësve në një zonë  
6 edhe xhepa të tjerëve në zona të tjera. Por ndërkohë kur  
7 merrnin thirrje për t'u bërë pjesë e një beteje, për shembull,  
8 ata të gjithë bashkoheshim me njëri-tjetrin. A e kuptova  
9 drejt?  
10 PË. Ashtu është, ashtu është, po, ashtu.  
11 PY. A ka qenë kështu situata në periudhën kur ju keni  
12 mbërritur në fillim të qershorit dhe deri në fund të verës?  
13 Domethënë, a ka qëndruar kështu situata nga qershori deri në  
14 fund të verës, në fillim të shtatorit?  
15 PË. Ashtu ka qenën gjithmonë duke kuptuar se ato pika që janë  
16 konë të voglat ata grusht njerëzish gjithmonë kanë shku duke u  
17 rritur. Por jo me pas kontrollin e rregull pa ndërpreme.  
18 PY. Pra, këto xhepat u rritën me kalimin e kohës, larat, siç  
19 i thoni juve. Por a e kam të drejtë që të themi që ishte e  
20 vështirë që të konsolidohej kontrolli në çdo kohë derisa u  
21 tërhoqën tërësisht forcat serbe pas bombardimit të NATO-s në  
22 mars, në fund të marsit të '99-s? A kam të drejtë këtë?  
23 PË. Shumë të drejtë. Shumë të drejtë e keni thënë.  
24 PY. Kjo është faza e parë. Do ju bëj disa pyetje të tjera.  
25 Megjithatë, domethënë është e rëndësishme për neve në këtë

1 pikë të kemi ndarë periudhat kohore, domethënë, nga java e  
2 parë e qershorit deri nga shtatori ose rreth shtatorit. Besoj  
3 se është e drejtë, nga intervistat e ndryshme që keni dhënë,  
4 Dëshmitar, që ju keni përshkruar një lloj ristrukturimi të  
5 UÇK-së për forcat që kishin mbetur në Ushtrinë Çlirimtare të  
6 Kosovës, duke filluar nga gjysma e dytë e nëntorit të vitit  
7 1998. Dhe duke vazhduar më tej deri më datë 8 mars 1999, a  
8 është e saktë kjo, Dëshmitar?

9 PË. E saktë.

10 PY Në përgjigje të një pyetje që ju ka bërë z. Pace lidhur  
11 me librin që keni shkruar ju folët për ristrukturimin që ka  
12 filluar poshtë në zonë në nivel zone. A mund të na shpjegoni  
13 tani për momentin se çfarë doni të thoni me këtë që  
14 ristrukturimi ka filluar nën nivelin e zonës dhe pastaj do të  
15 bëj ca pyetje të tjera përsëri lidhur me këtë.

16 PË. Fillimisht siç e thamë kanë qenë njësitë e vogla,  
17 skuadra, togje, kompani, batalione. Për të krijuar zona u  
18 dashtë të jenë tri brigada më shumë për ta bërë një zonë. Ne  
19 nuk kemi pas konsolidim të mjaftueshëm edhe të brigadave.  
20 Domethënë, një herë u dashtë të bashkohen tre e më shumë  
21 batalione në një brigadë, pastaj tri e më shumë brigada në një  
22 zonë. Dhe kjo ka fillu në fund të nëntorit, deri në fund të  
23 janarit '99. Kështu që ata që s'kanë pas më shumë se tri zona  
24 është quajt nënzona, nënzona e Nerodimës, nënzona e Llapit,  
25 nënzona janë quajtur.

1 Ata që kanë pas më shumë se tri brigada, katër, pesë  
2 sikur ne që kemi pas zonën e Pashtrikut e kemi themelu direkt  
3 zonën. Dhe komandanti i parë i kësaj zone, zëvendëskomandant  
4 ka qenë Sylejman Kollqaku, ndërsa komandant Drini, pas këtij  
5 konstruktimi të ri, pas këtij organizmi.

6 PY. Në fakt në mënyrë që të jemi të qartë tërësisht, zona e  
7 Pashtrikut nuk ka qenë ekzistente fare deri në atë periudhë  
8 ristrukturimi apo jo? Domethënë, në atë kohë është formuar si  
9 zonë operative, është e saktë kjo? Më përpara nuk ka  
10 ekzistuar, domethënë.

11 PË. Avokat më vjen keq, ndoshta konceptin ushtarak nuk e keni  
12 ose po i shtroni ndryshe. Zonë ka kuptimin përfshirjes me një  
13 territor, një hapësirë të ushtarëve vullnetarë të Ushtrisë  
14 Çlirimtare të Kosovës. Ndërsa si strukturë, nëse më thoni, nuk  
15 ka pasë strukturë para janarit '99. Kështu e kuptoj unë. Duhet  
16 ta kuptoni edhe ju kështu se kështu është e vërteta.

17 PY. Përpara '99-s?

18 PË. Përpara '99-s nuk ka pasë zona të strukturume. Zona e  
19 strukturum si duket nuk e keni kuptu drejt. Zonat kanë fillu  
20 të strukturohen, të themelohen si zona duke i bashkuar tri e  
21 më shumë brigada me një zonë nga fundi i nëntorit '98 deri në  
22 janar '99. E qartë?

23 PY. Po, gjatë kësaj periudhe kjo ndodhi. Megjithatë, ajo  
24 çfarë po mundohem që të them është që po befasohem ose po  
25 mundohem që të shpreh ca befasinë, sepse ju po thoni që

1 krijohet zona e Pashtrikut dhe caktohet komandant Drini si  
2 komandant i kësaj zone më vonë në '99 dhe jo që në fund të  
3 '98. Prandaj u duka pak i çuditur.

4 PË. Nuk kishte zona në '98. Ishte në strukturim e sipër.  
5 Komandant Drini ka ardhë me 16-17 dhjetor dhe ka fillu punën  
6 nga janari kur është konsolidu zona. E kuptoni?

7 PY. Në rregull. Dhe në këtë moment ka ardhur edhe Halil  
8 Qadraku apo jo?

9 PË. Po, po.

10 PY. Tani do të flasim pak më shumë për rolin që ka luajtur  
11 Halil Qadraku, sepse unë mendoj që ai ka ardhur javën e parë  
12 të janarit apo jo? Me sa mbani mend ju.

13 PË. Po. Halil Qadraku ka ardhur në janar, po.

14 PY. Dhe sipas Halil Qadrakut dhe mendoj që jeni dakord edhe  
15 me këtë, nuk ka patur strukturë informative inteligjence në  
16 zonë përpara se të vinte ai, sepse ai vetë ka thënë që duhet  
17 ta fillonte nga zeroja.

18 PË. Është e vërtetë. Biseda me Halilin edhe Drinin është bërë  
19 në Shqipëri dhe Ekrem Rexha "Drini" i ka thënë se do të  
20 emërohesh në nivel të zonës për zbulim dhe kundërzbulim në G2-  
21 shin, akoma pa mbërri në Kosovë. Dhe kështu që Halili në  
22 strukturat e para, në themelim të zonës është ka qenë i emërum  
23 për zbulim dhe kundërzbulim në G2.

24 PY. Po nuk është se ai po bëhej komandant i një strukture të  
25 mëparshme të zbulim-kundërzbulimit. Pra ai duhet ta fillonte



1 nga zeroja apo jo?

2 PË. Rregullat janë të tilla ushtarake që caktohet personi  
3 pastaj rreth vetes krijon stafin dhe funksionalitetin. Nuk ka  
4 pas asgjë të organizume më herët rreth asaj çka është folni ju  
5 për zbulim dhe kundërzbulim.

6 PY. Gjatë kësaj periudhe të ristrukturimit ne e dimë që ju  
7 nuk shërbenit më si komandant batalioni, por si personi me  
8 përgjegjësinë për moralin dhe informimin, a është e saktë kjo?

9 PË. Po, e saktë është.

10 PY. Dhe kjo është brenda përbrenda zonës jo për të gjithë  
11 Kosovën. Pra është përgjegjësi për një zonë të caktuar apo jo,  
12 për zonë e Pashtrikut?

13 PË. Gjithmonë flas për zonën e Pashtrikut dhe përgjegjësitë  
14 kanë qenë në zonën e Pashtrikut.

15 PY. E kuptoj, por një nga këto problemet që kemi ne me  
16 etiketimin kur sa herë përdorim fjalën "informimi" ose  
17 "formim", për sa i përket përgjegjësive përkthehet sikur është  
18 "inteligjencë", informim, zbulim dhe kundërzbulim.

19 Por do ta shikojmë edhe në disa dokumente të rolit tuaj,  
20 por kur ju përgjegjësitë i kishit për moralin dhe informimin  
21 ky ishte rol që kishte të bënte me komunikimin dhe jo me  
22 mbledhjen e informacioneve sekrete, zbulim-kundërzbulim apo  
23 jo?

24 PË. Por unë nuk thashë se unë kam qenë zbulim-kundërzbulim,  
25 nuk e di pse e ngatërruat. Nuk e thashë.

1 PY. Jo, jo. Jo, jo. Nuk po i ngatërroj unë.

2 PË. S'kam qenë asnjëherë.

3 PY. Jo, nuk po i ngatërroj unë. Por nëpër përkthime zakonisht  
4 ka gabime për informimin si inteligjencë. Pra, duhet të  
5 shikojmë se si është përkthyer roli juaj në pikat, në momente  
6 të ndryshme të historisë. Pra, edhe një herë, a mund të na  
7 tregoni në shqip ju vetë cila është fjala për "informim"?

8 PË. Roli im ka qenë ndihmëskomandant për çështje morale-  
9 politike. S'ka të bëjë as me informim as me zbulim-  
10 kundërzbulim. Nëse doni t'ju shpjegoj çka është kundërzbulimi-  
11 zbulimi jam në gjendje t'ju shpjegoj. Nëse duhet t'ju shpjegoj  
12 për detyrat e mia jam në gjendje t'ju shpjegoj. Jo të m'i  
13 ngatërroji detyrat mes zbulimit edhe informimit.

14 PY. Do t'ju kërkoj, do t'ju kërkoj që t'i bënit të dyja këto  
15 gjëra, sepse unë po përpigem që ne të kuptojmë, pra, se pse  
16 jemi ngatërruar. Jo të bëj të ngatërroj më shumë Gjykatën.  
17 Sepse në disa dokumente në këtë moment është shpjeguar sikur  
18 roli juaj ka të bëjë me moralin dhe me inteligjencën, pra,  
19 zbulim-kundërzbulimit. Ndërkohë që ju thatë që s'ka qenë  
20 kështu apo jo?

21 PË. Nuk ka qenë ashtu. Nëse na lejon Gjykatësi sa të doni  
22 pyetni jam në gjendje të përgjigjem. Se jam për të dalë e  
23 vërteta dhe vetëm e vërteta. Se sa më shpejt që del e vërteta  
24 këta djem këtu nuk i mbani kot, shkojnë në shtëpi.

25 PY. Atëherë, ju lutem, dëgjoni së pari pyetjen time: A mund

1 të na jepni fjalën në shqip, vetëm fjalën për "informacion",  
2 "informimin", cila është kjo fjalë në shqip?

3 PË. Fjala në shqip "informacion" ka atë kuptimin televizion,  
4 gazetë, në radio, në publik, kjo informacion është.

5 PY. Dhe fjala në shqip?

6 Z. EMMERSON: [Përkthim] Nëse mund të na lexohet në shqip,  
7 pra, informacion apo jo?

8 PY. Dhe fjala për "inteligjencë", në kuptimin sekret, pra,  
9 zbulim-kundërzbulim, cila është fjala për inteligjencën në  
10 shqip?

11 PË. Shërbimi inteligjent do të thirrej në shqip, do të quhej  
12 shërbim inteligjent. Nëse është fjala për zbulim dhe  
13 kundërzbulim të kohës së UÇK-së është fjala të zbulosh armikun  
14 dhe të kundërzbulosh qëllimet e armikut ndaj nesh. Këtë kuptim  
15 ka.

16 PY. Edhe një herë, pra, dua, ju lutem, dëgjoni pyetjen time,  
17 me vëmendje, ju lutem. Se ndoshta ju e keni bërë ndryshe  
18 gjithë këtë gjë. Sepse ju keni thënë në intervistat tuaja  
19 natyrisht për të bërë dallimin ndërmjet ZKZ-së, ZKZ në shqip,  
20 dhe SHIK-ut.

21 Së pari, a mund t'u tregoni Gjyqtarëve se çfarë do të  
22 thotë ZKZ-ja, çfarë ishte ZKZ-ja dhe çfarë ishte SHIK-u dhe  
23 kur u krijua SHIK-u, kur filloi SHIK-u të ekzistonte? Se disa  
24 njerëz ngatërrohen me këto të dyja apo jo?

25 PË. Sigurisht që mund të ngatërrohen, por në këtë rast nuk

1 kemi qëllim t'i ngatërrojmë me qëllim. Kemi qartë se ZKZ-ja ka  
2 fillu domethënë në zonën teme po flas për mu në janar të '99-  
3 s dhe ka funksionu shumë çaltë sepse s'ka pas strukturë sa  
4 duhet dhe s'ka funksionu sa duhet po efektiviteti i detyrave  
5 të saj ka qenë i vlefshëm për ne shumë. Se ata kanë zbuluen  
6 njësitë e armikut, kanë zbuluen llojet e armëve, pozicionet e  
7 armikut, minimet e armikut, qëllimin ku do të sulmojë armiku  
8 dhe si mund të depërtojë apo kohën kur do të ketë beteja. Kjo  
9 ka qenë detyra e ZKZ-së. Sa i përket detyrës së shërbimit  
10 informativ apo si e quani ju SHIK unë nuk kam lidhje me atë  
11 shërbim, s'kam pas asnjë qasje. Ajo ka ndodh mbas shpërbërjes  
12 të UÇK-së, mbas është fol që ka pas shërbim informativ. Për  
13 atë mund t'ju tregojë më mirë atë që e mbron ju Kadri Veseli  
14 sesa unë.

15 PY. Duke iu kthyer ZKZ-së, ju thoni që në zonën tuaj kjo  
16 filloi të ekzistonte së pari në janar dhe siç na thatë edhe  
17 pak para pak çastesh kjo ka ndodhur për shkak të emërimit të  
18 Halil Qadrakut apo jo?

19 PË. Po normal. Fillestare ka qenë fillimi me emërimin e Halit  
20 Qadrakut. Edhe ai ka bë dy-tre të tjerë bashkëpunëtorë dhe  
21 kanë bë punën e tyre që iu ka taku ta bëjnë.

22 PY. Tani t'i kthehem fjalës SHIK, SH-I-K. A mund të na  
23 tregoni çfarë do të thotë SHIK, pra, sepse SH-I-K dhe K-ja në  
24 veçanti për çfarë është, fillimi i cilës fjalë?

25 PË. Shërbimi Informativ i Kosovës. Sikurse që janë shërbimet

1 e tjera, Shërbimi Informativ i Shqipërisë, SHISH. Siç është  
2 Shërbimi Informativ Ushtarak i Shqipërisë, SHIU e të tjera e  
3 të tjera. Ju këto i dini z. Avokat, por sigurisht doni të më  
4 veni në provim, në provim unë jam para Gjykatësit jo para  
5 juve.

6 PY. Jo, jo, aspak, aspak. Por dëgjo shumë njerëz nuk i bëjnë  
7 dot këto dallime dhe nuk i dini këtë gjëra, përfshirë edhe  
8 disa që janë këtu në Gjykatë. Kështu që është shumë e  
9 rëndësishme që ne të bëjmë dallimin mes këtyre. Sidomos kur  
10 kemi dëshmitarë që të kuptojmë edhe strukturat dhe dallimin  
11 ndërmjet tyre.

12 Në Shqipëri shërbimi inteligjent ka patur edhe ai emrin  
13 SHIK apo jo? Pra, Shërbimi Inteligjent Kombëtar i Shqipërisë,  
14 i inteligjencës.

15 PË. SHISH, SHISH, jo SHIK, SHISH.

16 PY. Po fjala "kombëtar" çfarë do të thotë?

17 PË. "Nacional", kombëtar e njëjtë është. Kombëtar,  
18 "internacional" është internacional, nacional është kombëtar.

19 PY. Pra, ajo që po përpiqem t'ju sugjeroj dhe besoj që jeni  
20 dakord me mua që brenda përbrenda Kosovës do të thosha unë  
21 deri kur u krijua edhe qeveria e pavarur e Kosovës nuk ka  
22 patur një organizatë brenda UÇK-së që quhej SHIK?

23 PË. Jo, jo, por UÇK-ja është transformuar më 19 shtator, u  
24 transferua në TMK dhe s'ka pas normal që s'ka pas SHIK në UÇK.

25 PY. Por termi, fjala e saktë që u përdor brenda UÇK-së ka

1 qenë ZKZ-ja si akronim që e përmendët edhe ju.

2 PË. Po, po.

3 PY. Po a është e saktë, dhe ju e keni thënë edhe në disa  
4 intervista që shumë njerëz i ngatërronin këto dy emërime,  
5 emërtime - më falni.

6 PË. Është shumë e saktë se nuk e dini njerëzit shërbimet  
7 përpos ata që kanë lexu më shumë, kanë studiu më shumë ose  
8 kanë punu në shërbime.

9 PY. Atëherë më lejoni që në këtë lloj konteksti t'ju bëj këtë  
10 pyetje. Më falni pak, ju lutem; më jepni pak kohë. Vetëm një  
11 sekondë, ju lutem.

12 Z. EMMERSON: [Përkthim] A është e mundur që në ekran dhe  
13 më duket se për identifikim e kemi quajtur SITF00021875 deri  
14 në 876-ET që më duket tani quhet P500 apo jo? Nëse mundem ta  
15 shfaqim në ekran dhe e kemi edhe përkthimin në shqip.

16 PY. Ky është një dokument për të cilin jeni pyetur tashmë; ju  
17 është bërë pyetja nga z. Pace. Dhe shikojmë që data është 14  
18 mars e vitit 1999. Dhe këtu jepet shpjegim për ju ose le t'i  
19 lexojmë fjalët, unë do t'i lexoj në anglisht:

20 "Unë, Shefi i Shërbimit Informativ, Halil Qadraku dhe  
21 shefi për moral dhe informim Sadik Halitjaha, lëshojmë këtë  
22 deklaratë:".

23 Pra, këtu ju shpjegoheni për shkruheni si shefi për moral  
24 dhe informim. Në fakt inteligjencë thuhet tek anglishtja. A  
25 mund të na e shpjegoni nga mënyra pra, që dallimin që na bëtë

1 ju nga shqipja, çfarë do të thotë, çfarë fjalë është përdorur  
2 në shqip?

3 PË. Tash e shoh që keni pasë të drejtë në gjithë atë  
4 pretendim për t'u përgjigj. Fjala "informim" duhet të  
5 zëvendësohet me fjalën "politikë". Fjala "Unë, Shefi i  
6 Shërbimit Informativ" është gabim. Ai ka qenë shefi i zbulimit  
7 dhe i kundërzbulimit, por Halit Qadraku ka lexu literaturë pak  
8 në Shqipëri edhe ka kujtu që është tuj e lujt rolin e  
9 shërbimit inteligjent, informativ. Nuk ka qenë kështu. Ju do  
10 ta pyetni Halil Qadrakun më së miri e sqaron këtë punë.

11 A unë nga ajo që e di se çfarë roli ka pas Halili se ka  
12 qenë vartësi imi, unë them se e drejta është ta kishte shkruar  
13 "Unë, Shef i Zbulimit dhe i Kundërzbulimit dhe Sadit Halitjaha  
14 Shef për Moral dhe Politikë në UÇK. Kështu do të ishte kjo në  
15 rregull. Për mendimin tim nuk është në rregull. Edhe nuk e ka  
16 bë me qëllim, por e ka bë pavetëdije; nuk e ka njoh  
17 terminologjinë.

18 PY. Megjithatë, për të qenë të qartë për këtë gjë, fjalët që  
19 janë përdorur në gjuhën shqipe ju shpjegojnë juve, më falni se  
20 do ta bëj unë përkthimin tani si "shefi për moral dhe  
21 informim". [e pakuptueshme] sa të bëj pyetjen, ju lutem, më  
22 prisni. "Informim" nuk është inteligjencë apo jo?

23 PË. Realisht për t'u kuptu drejt pozicioni im, s'ka të bëjë  
24 me informimin; ka pasë të bëjë me çështjen morale-politike dhe  
25 nëse them informacion është marrë me informim. Në

1 inteligjencën e zbulimeve është diçka krejt tjetër karshi

2 çështjes moralo-politike.

3 PY. Okej.

4 PË Dhe kështu është termi që nuk e ka njohtë Halil Qadraku

5 çka do të thotë informim dhe nuk e ka njoftë që është shërbim

6 informativ SHIK, por ai ka qenë zbulim-kundërzbulim. Ka mund

7 ta bëjë gabim edhe jam 200 për qind që është gabimisht prej

8 tij, pasi që s'e ka njoftë.

9 PY. Okej, na ndihmon kjo. Ndoshta ka gabuar ai vetë. Por ju

10 lutem dëgjoni pak me vëmendje pyetjen time për fjalën

11 "informim" është ndryshe nga "zbulimi" apo jo? Nuk është e

12 njëjtë gjë?

13 PË. Po s'është e njëjta gjë se ta zbulosh duhet ta kërkosh,

14 ta gjesh dhe ta zbulosh, ta informosh mund ta kesh dëgju, ta

15 kesh pa. Edhe bën informim. Nuk është e njëjta gjë; s'është e

16 njëjta gjë, por nuk ka qenë kjo detyrë e imja, as të informoj

17 as të zbuloj.

18 Z. EMMERSON: [Përkthim] Më duket se kemi probleme me

19 procesverbalin, zbardhjet e procesverbalit e cila bëhet në

20 moment. Do pres pak që të shfaqet në ekran transkripti.

21 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Po mund të

22 vijojmë.

23 Z. EMMERSON: [Përkthim] Po, mendoj se po funksionon tani.

24 PY. Atëherë edhe një herë. Thjesht sot pasdite dëshiroja që

25 ta kishim të sqaruar këtë çështje. Pra, në shprehjen ZKZ, ose



1 në shkurtimin ZKZ, fjala është "zbulim" apo jo?

2 PË. Z, Zbulim; K, Kundërzbulim, ZKZ, Zbulim-Kundërzbulim.

3 PY. Po, po faleminderit. Pra, është zbulimi dhe  
4 kundërzbulimi.

5 Tani SHIK-u dhe këtë dua t'ju them, ka qenë si fillim  
6 Shërbimi i Inteligjencës së Shqipërisë, kështu është njohur  
7 gjatë regjimit komunist si Sigurimi njihej ndryshe si SHIK-u  
8 apo jo? A e dini ju këtë gjë?

9 PË. Po, është sigurim kombëtar, ashtu, ashtu ka qenë.

10 PY. Po, po. Dhe më pas në vitin 1991 u ndryshua emërtimi në  
11 SHIK, Shërbimi Informativ Kombëtar, e saktë?

12 PË. Po, po, korrekt.

13 PY. E më pas në vitin 1997 u ndryshua emërtimi në atë që  
14 njihet si SHISH, saktë?

15 PË. Korrekt, e saktë, e saktë.

16 PY. Të jemi të qartë, thjesht që të jemi të qartë. Pra, emri  
17 me të cilin njihej shërbimi sekret i Shqipërisë nga vitit 1991  
18 deri në 1997 ka qenë SHIK, Shërbimi Informativ Kombëtar. Pra,  
19 me fjalë të tjera shërbimi kombëtar i inteligjencës,  
20 informativ apo jo? Është e saktë?

21 PË. Qartë. Unë nuk e di, ndoshta juve po jua asocion po ju  
22 asocion te shërbimi informativ i Kosovës se ka "K" në fund.  
23 Duhet ta keni të qartë Kosovës dhe kombëtar. Kur flitet për  
24 shërbimin informativ kombëtar është fjala për shërbimin në  
25 Shqipëri. Flitet për shërbimin informativ të Kosovës është

1 fjala për SHIK të Kosovës. Besoj se e keni të qartë edhe ju.  
2 PY. Por gjithsesi në secilën prej tyre i referohet një  
3 shërbimi në rrafsh kombëtar. Në rastin e Kosovës pas luftës  
4 dhe krijimit të natyrisht të TMK-së.  
5 PË. Nuk kemi pretendu ne me pasë shërbim kombëtar, sepse  
6 Kosova është Kosovë, Shqipëria është Shqipëri, dy shtete janë.  
7 Shërbimi nëse ka qenë te ne ka qenë në nivel të Kosovës.  
8 PY. E kuptoj, e kuptoj, por gjithsesi është shumë e  
9 rëndësishme që ne këtu në Gjykatë ta kuptojmë këtë gjë. Sepse  
10 kur flasim për faktin që ju keni nënshkruar këtu në fund të  
11 këtij dokumenti sepse ky është një dokument i cili mban  
12 inicialet tuaja dhe emrin tuaj edhe pse është nënshkruar nga  
13 Halil Qadraku. Dhe aty thuhet që ka tre kopje; është në arkiv  
14 për Shtabin e Përgjithshëm dhe për SHIK-un te Shtabi i  
15 Përgjithshëm dhe ka datën 14 mars 1999.  
16 Pse do shkruante zoti -- do t'i shkruante z. Qadraku  
17 SHIK-ut në mars të vitit 1999 [e pakuptueshme] në fakt SHIK-u  
18 nuk ekzistonte, nuk kishte ekzistuar deri në atë moment, por  
19 krijohet më vonë. Mendoni ju, ka pasë ndonjë arsye për këtë?  
20 PË. Thashë perceptimi i Halilit në bazë të literaturës që ka  
21 lexu në Shqipëri dhe ka shkru njësoj sikur atje që ka lexu ka  
22 mendu se edhe këtu ka SHIK. Se s'ka pasë, nuk ka pasë, s'kem  
23 pse. Kjo nuk është, çfarë relevance ka kjo për ta thënë të  
24 pavërtetë se ka pas, nuk ka pasë. Të them të vërtetën më qartë  
25 e ke. Nuk ka pasë SHIK.

1 PY. Me thënë të drejtën ka dalë në disa kontekste përdorimi i  
2 fjalës "SHIK" në të njëjtën mënyrë. Pra, përshkrimi i  
3 pozicionit gjatë luftës nuk është i vetmi dokument, por ju  
4 keni bërë koment në intervistat tuaja që e keni dëgjuar që  
5 këto gjëra i ka bërë gabim edhe në të shkuarën apo jo?

6 PË. I ka bërë gabim Halili, duke pas të menduarin atë që ka  
7 lexu në Shqipëri. Përndryshe ndonjë lapsus ka mund edhe unë  
8 ndoshta ta bëj, sepse ne e kemi konsideruar se Sshërbimi  
9 Informativ i Shqipërisë do të ishte i ngjashëm diçka dhe  
10 shërbimi jonë. Në atë kuptim, por nuk ka pasë, nuk ka pasë  
11 atëherë të Kosovës s'ka pasë për kohën që po flasim.

12 PY. Okej, së pari më lejoni t'ju pyes, e lexuat këtë gjë  
13 përpara se të dërgohej, të shpërndahej në emrin tuaj, e keni  
14 lexuar më parë?

15 PË. Nuk më kujtohet por edhe mos me e pasë lexuar i kisha  
16 besu Halilit. Se s'ka pasë ndonjë diversion me kë të bëjë  
17 diçka. S'ka qenë relevante kjo që të ndikojë diçka negativisht  
18 për UÇK-në. Edhe mos me e pasë lexuar i kisha besu. Se di a e  
19 kam lexu, nuk më kujtohet.

20 PY. Në fakt ju keni folur për disa dokumente dhe për të cilat  
21 Prokuroria ju ka kërkuar që të bëni komente në dëshminë tuaj,  
22 rregulla, rregullore të UÇK-së, organigrami i UÇK-së,  
23 struktura e saj dhe në momente të ndryshme ju keni bërë  
24 komente, keni dhënë komentet tuaja që ju prisnit që lufta të  
25 ishte një luftë e gjatë dhe u morëm ose u menduan hapa të

1 caktuar që në fakt nuk ekzistonin. Pra, çfarë hapash do të  
2 ndërmerreshin.

3 Z. PACE: [Përkthim] Nuk e kuptoj pyetjen, nuk e kuptoj  
4 pyetjen dhe në fakt nuk është e qartë dhe njëra pjesë nuk  
5 ndjek tjetrën.

6 Z. EMMERSON: [Përkthim] Në rregull. Do ta bëj unë të  
7 qartë.

8 DËSHMITARI: Unë e kuptoj. Veç të na lejon. A bën me fol?  
9 Nëse na lejon Gjykatësi.

10 90 për qind e dokumenteve të zonës operative të  
11 Pashtrikut që janë shkruar unë i kam diktue, Halit Qadraku i  
12 ka shkrujt, i ka daktilografu, se kemi pasë veç një laptop  
13 edhe ato rregulloret që thoni ju janë bë prej meje, prej  
14 Halilit edhe ndonjë shok tjetër që na ka ndihu. Të gjitha që  
15 janë të nënshkrume prej meje unë i pranoj si të miat, asnjë  
16 gjë nuk du me heq, sepse ato i kanë mbet arkivit të UÇK-së e  
17 për fat të keq tani i ka marrë EULEX-i i ka mbledh të gjitha.  
18 Përndryshe nuk kam kurrgjë kundër asaj as të fshehi diçka.

19 Për këtë deklaratë, një deklaratë sipas juve çfarë  
20 diversioni bën ose çfarë relevance ka në të mirën apo në të  
21 keqen e UÇK-së apo të Kosovës? Ju lutem, pse gjithë kjo ka  
22 gabu, ka shkru "SHISH" e ka shkru "SHISH". Ca ka bë keq?

23 Z. EMMERSON: [Përkthim]  
24 PY. Në fakt ishte "SHIK", jo "SHISH", por s'ka gjë, e kemi  
25 kaluar këtë gjë. Nuk i përgjigjem unë dot pyetjeve tuaja, por

1 duhet ta pranoni që në fakt pyetjet i bëj unë dhe nuk ju jap  
2 dot opinionet e mia, mendimet e mia në lidhje me këto çështje.  
3 Megjithatë, më lejoni t'jua them haptazi fare. Ju keni  
4 nënshkruar dokumente në të cilat flitet për një individ dhe që  
5 në fakt do të duhet të dalin përpara një gjykate të shkallës  
6 së dytë, ju keni prodhuar dhe keni identifikuar rregulla të  
7 UÇK-së që flasin për një sistem, pra, hetuesish, prokurorësh,  
8 gjykatash edhe struktura të tjera se si duhet të ekzistojnë  
9 dhe duhet të funksionojnë gjërat, por asnjë nga këto gjëra nuk  
10 ekzistonin në atë kohë. Realiteti ky ishte apo jo?

11 Z. PACE: [Përkthim] Kundërshtoj. Përpara se të përgjigjet  
12 dëshmitari kjo është një pyetje e përbërë nga shumë pjesë dhe  
13 në rast se avokati i z. Veseli dëshiron që të parashtrojë  
14 dokumente apo gjëra të ndryshme, ju lutem, vendosini ato që  
15 edhe ne t'i kuptojmë.

16 Z. EMMERSON: [Përkthim] Në rregull atëherë. Do ta  
17 thjeshtoj.

18 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ashtu do të  
19 bëhet.

20 Z. EMMERSON: [Përkthim]

21 PY. Pra, ju keni nënshkruar dhe një dokument ku flisni që një  
22 individ duhet të çohet te një gjykatë e shkallës së dytë. Ja  
23 të flasim pikërisht për këtë si shembull. Nuk ka patur gjykatë  
24 të shkallës së dytë apo jo?

25 Z. PACE: [Përkthim] Edhe një herë kundërshtoj. A mund ta

1 shikojmë këtë dokument? Për cilin dokument po flasim? Nuk mund  
2 të flasim në formë abstrakte, sepse edhe dëshmitari duhet t'i  
3 shikojë ato, sepse këtu po flitet për shumë dokumente.

4 Z. EMMERSON: [Përkthim] Unë po përpiqem që të ec përpara  
5 duke folur për diçka të përgjithshme. Megjithatë do të arrij  
6 të flas edhe për këtë dokument. Natyrisht jemi në fund të  
7 ditës dhe në fakt është goxha e bezdisshme që kur unë po flas  
8 për një gjë të përgjithshme dhe shumë të vlefshme më  
9 ndërpresin.

10 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Në fakt na  
11 keni ndërlikuar këtë gjë.

12 Z. EMMERSON: [Përkthim] Atëherë bëhet fjalë për U000-  
13 1551-ET. Duhet të ketë edhe një dokument origjinal që  
14 korrespondon pikërisht me këtë.

15 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Është Prova Materiale  
16 P716.

17 Z. EMMERSON: [Përkthim] Po, faleminderit. Është dhënë në  
18 fakt si provë sot pasdite. Në rregull.

19 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Po.

20 Z. EMMERSON: [Përkthim] Ju kërkoh ndjesë. Nuk i kemi  
21 pasur numrat përkatës.

22 PY. Atëherë po ta shikojmë këtë dokument dhe duke parë pjesën  
23 e poshtme, pjesën poshtë të saj, z. Halitjaha, këtu thuhet që  
24 jeni ju ai që e ka shkruar këtë dokumentazh, ky është  
25 nënshkrimi juaj?

1 PË. Jo, s'ka nënshkrim këtu. Është shkruar me kompjuter emri  
2 im. Ma kthe në fillim që ta lexoj për ta kuptuar a është e  
3 imja apo jo. Nuk ka nënshkrim timin.

4 PY. Atëherë po të shkojmë, okej, të shkojmë prapë poshtë  
5 përpara se të shkojmë lart. Pra, poshtë fjalëve që shprehin  
6 emrin tuaj duke si një inicial i shkruar me stilolaps. A është  
7 një firmë kjo që keni përdorur ju, nënshkrim që keni përdorur  
8 ju? Mu poshtë emrin tuaj.

9 Z. EMMERSON: [Përkthim] Tek origjinali që është një  
10 shqip.

11 PË. Te origjinali në --

12 PY. E keni në të dyja gjuhët përpara jush në ekran.

13 PË. Po, po është nënshkrimi im, po.

14 PY. Faleminderit. Tani të shkojmë lart në pjesën e sipërme të  
15 këtij dokumenti. Data është 8 shkurt 1999 dhe shpjegohet si  
16 informatë për njësitë e UÇK-së në lidhje me rastet e  
17 jashtëzakonshme. Dhe këtu bëhet edhe i referohet këtu në pikën  
18 1, plagosjes së një ushtari me emrin Bashkim Kryeziu nga shoku  
19 dhe bashkëluftëtari i tij dhe më pas jepet edhe një shpjegim i  
20 ngjarjes si ka ndodhur. Në fjalinë e fundit të këtij paragrafi  
21 thuhet:

22 "Edhe pse do të vuaj tërë jetën për shkak të kësaj  
23 ngjarjeje ai do të përgjigjet pranë gjykatës së shkallës së  
24 dytë".

25 Dhe në pikën 2, pra, vijon, flitet për rastin e vrasjes

1 pa dashje në zonën e Neredimës nga një ushtar tjetër "i cili  
2 vuan dënimin për momentin dhe pret përcaktimin e përgjegjësisë  
3 së tij pranë së njëjtës gjykatë". Z. Halitjaha, po nuk ka  
4 patur gjykatë të shkallës së dytë më 8 shkurt 1999.

5 PË. Ju jo pa qëllim i kaloni njërën para tjetrës, se para  
6 kësaj ka pasë një kërkesë që kemi bë publike dhe jemi drejtu  
7 edhe Shtabit të Përgjithshëm, atëherë kemi mendu që duhet të  
8 ketë gjykata për disiplinën e ushtarëve, sepse kanë ndodhur  
9 ngjarje të tilla. Ushtarët duke i mbajt armët me fishekun në  
10 grykë gabimisht i ka shkrep arma dhe e ka plagos, tjetri  
11 gabimisht e ka vra. Dhe ne kemi mendu që duhet të krijohen  
12 gjykatat. Kjo është mendu, po të kishte zgjat lufta dhe një  
13 vit, dy apo tre ndoshta dhe pas lufte për me u marrë parasysh  
14 këto gjëna. Përndryshe s'ka pas. S'ka pasë UÇK, s'ka pasë  
15 gjykata.

16 PY. Pra, ju po shkruanit këtu për një gjykatë që shpresonit  
17 dhe që të gjithë kishin kërkuar që të fillonte të ekzistonte  
18 dikur në të ardhmen në një konflikt të gjatë, sepse kështu  
19 pritej që konflikti do të ishte i gjatë dhe do të zgjaste  
20 goxha?

21 PË. Ka qenë shumë e vështirë kjo veç si dëshirë dhe ide ka  
22 qenë, përndryshe ne s'kemi paës ligje të Kosovës; nuk kemi  
23 pasë avokatë si tash që jeni ju këtu; s'kemi pasë prokurorë;  
24 s'kemi pasë infrastrukturë fizike, gjykata, burgje; nuk kemi  
25 pasë. Edhe kjo nuk ka mund të ndodhë derisa s'ka pasë Kosova



1 parlament për t'i aprovu ligjet. Ato ligje që janë përdor në  
2 Kosovë para lufte kanë qenë ligje të pushtuesit që ne e kemi  
3 luftu atë pushtues. S'kena mund të gjykojmë me ligjet e  
4 pushtuesit se ndoshta kishim gjet avokat me përvojë edhe  
5 gjykatës të asaj kohe gjatë pushtimit që kanë punu. Pra, nuk  
6 ka pasë. Vetëm ka qenë tentativë dhe kërkesë për t'u bë diçka  
7 e tillë në një kohë të caktuar. Sigurisht ajo kohë do të ishte  
8 e gjatë.

9 PY. E kuptoj këtë gjë dhe ky është informacion që në fakt ju  
10 ia kishit dhënë Prokurorisë edhe më parë dhe prandaj fola për  
11 të në formë të shkurtuar. Megjithatë, pothuajse kemi arritur  
12 në fund të seancës së ditë së sotme. Megjithatë më lejoni t'ju  
13 bëj një pyetje të përgjithshme.

14 Duke u bazuar te ky dokument si shembull dhe kësaj mund  
15 t'i përgjigjeni me një përgjigje "po" ose "jo" në mënyrë që të  
16 mos ta zgjasim ditën e sotme.

17 A është e vërtetë që shumë nga dokumentet të cilat, për  
18 të cilat ju është kërkuar që të bëni komente ose që janë  
19 sjellë në Gjykatë u referohen strukturave të cilat priteshin  
20 që do të ekzistonin në të ardhmen?

21 PË. Shumica po.

22 PY. Faleminderit.

23 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faleminderit,  
24 Dëshmitar. Kjo sjell në përfundim dëshminë tuaj për ditën e  
25 sotme.

1 Ju e dini që as nesër as të mërkurën nuk do të jeni  
2 përpara Gjykatës, por do të ktheheni në Gjykatë ditën e enjte  
3 në orën 09.00. Faleminderit për ditën e sotme dhe mund t'ju  
4 ndihmojë Sekretarja.

5 DËSHMITARI: Faleminderit.

6 Z. PACE: [Përkthim] I nderuar Gjykatës, nëse mundem  
7 ndërkohë që dëshmitari largohet nga salla. Kemi patur një  
8 kërkesë që u bë nga Gjyqtari Mettraux.

9 Në fakt është shumë e qartë që ka patur një gabim nga ana  
10 jonë që nuk e kemi përmendur, por duke e parë atë flitet në  
11 fakt për faqen 3126 [sipas përkthimit].

12 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Nëse mund të  
13 rregullojmë transkriptin, ju lutem. Faleminderit. Ta  
14 korrigjomë atë.

15 [Dëshmitari largohet]

16 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Po, do ta korrigjomë  
17 atë.

18 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Z. Emmerson,  
19 keni diçka tjetër për të thënë?

20 Z. EMMERSON: [Përkthim] Urdhëroni?

21 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Keni diçka  
22 tjetër për të thënë?

23 Z. EMMERSON: [Përkthim] Jo, faleminderit.

24 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Atëherë do të  
25 shihemi nesër në orën 15.00. Ndoshta ide e mirë do të ishte që

1 të vinim pak më përpara në salla, sepse bëhet fjalë për një  
2 lidhje me anën e videos në distancë, kështu që do të ishte  
3 mirë të ishim në sallë që më herët.

4 Faleminderit. Këtu mbyllet seanca e sotme.

5 --- Seanca mbyllet në orën 16.05

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25